VENDIM
Nr. 402, datë 9.6.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES HIDROKARBURE ME NDARJE PRODHIMI PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN E GAZIT NATYROR POVELÇË, NË SHQIPËRI, NDËRMJET "ALBPETROL" SHA DHE "EDG NATURAL GAS" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure me ndarje prodhimi për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit natyror Povelçë, në Shqipëri, ndërmjet "Albpetrol" sh.a., dhe "EDG Natural Gas" sh.p.k., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "Albpetrol" sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJA HIDROKARBURE

ME NDARJE PRODHIMI

Për

ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN E GAZIT NATYROR POVELÇË, NË SHQIPËRI

ndërmjet

ALBPETROL SH.A.

dhe

EDG NATURAL GAS SHPK

Tiranë, më 27.05. 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

Neni Faqe

1. Përkufizime A-3
2. Qellimi i Marreveshjes, Anekset e Marreveshjes A-10
3. Kohezgjatja A-13
4. Heqja Dore A-16
5. Kryerja e Operacioneve A-17
6. Periudha e Vleresimit A-19
7. Zhvillimi dhe Prodhimi A-20
8. Programet Vjetore dhe Buxhetet A-21
9. Pjesa e Albpetrol, hidrokarbure fitim dhe rikuperimi i kostove A-23
10. Bonueset e Trajnimit, prodhimit dhe nenshkrimit A-24
11. Titujt ndaj aseteve A-25
12. Te drejtat dhe detyrimet e paleve A-26
13. Tatimet dhe Taksat Shqiptare A-28
14. Importet dhe Eksportet A-29
15. Librat Kontabel, Kontabiliteti dhe Pagesat A-29
16. Transferimi i Interesave A-30
17. Forca Madhore A-31
18. Legjislacioni i zbatueshem A-32
19. Mosmarrëveshjet dhe zgjidhja e tyre A-33
20. Mbrojtja e Mjedisit A-35
21. Mallrat dhe Sherbimet A-35
22. Konfidencialiteti A-36
23. Abandonimi (Dekomisionimi) A-36
24. Zgjidhja A-38
25. Auditet A-39
26. Klauzola te Pergjithshme A-39

Aneksi A Përshkrimi i Zonës së Marreveshjes A-42
Aneksi B Harta e Zonës së Kontratës A-43
Aneksi C Proçedura Kontabël A-44

Aneksi D	Instrumenti i Transferimit	A-54
Aneksi E	Forma e Garancisë Bankare	A-56
Aneksi F	Procedura e Marrjes ne Dorezim	A-58
Aneksi G	Programi i Vlerësimit	A-62

MARRËVESHJA HIDROKARBURE
ME NDARJE PRODHIMI

PËR

ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN E GAZIT NATYROR
POVLEÇË, NË SHQIPËRI

ndërmjet

ALBPETROL SH.A.

dhe

EDG NATURAL GAS SHPK

Kjo Marreveshje Hidrokarbure nënshkruhet sot më Datë 27.05 2022,

NDERMJET

-**ALBPETROL SH.A**, shoqeri tregtare e regjistruar dhe qe funksionon sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, me seli ne Rruga Fier-Patos, km i 7-te, me NIPT J82916500U, perfaqesuar nga Z. Klejdi Cenmurati, ne cilesine e Administratorit te shoqerisë (ketu e me poshte referuar si "Albpetrol");

dhe

-**EDG NATURAL GAS SHPK**, person juridik shqiptar, shoqëri me pergjegjesi te kufizuar, e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar më datë 07.05.2021, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NIPT-M11707029T, me adresë në Rrugën e Elbasanit, Vila Nr. 71, Tiranë, Shqipëri, perfaqesuar nga Z. Erald Bakiu ne cilesine e Administratorit te shoqerise (këtu e më poshtë referuar si "EDG Natural Gas");

KUSHTET PARAPRAKE :

NDËRSA, të gjitha burimet natyrore, duke përfshirë mineralet dhe Hidrokarburet që gjenden në Republikën e Shqipërisë janë pronë e Republikes se Shqipërisë;

NDËRSA, Operacionet Hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë rregullohen nga Ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe nëse nuk përmenden diku tjetër në këtë Marreveshje, kryesisht nga ligjet dhe rregulloret si më poshtë: Ligji nr. 7746, Datë 28.07.1993 "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", *të ndryshuar*, Ligjin nr. 153/2020 "Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.

NDËRSA, Albpetrol Sh.a., Bazuar ne Nenin 12 te Ligjit nr.7746, date 28.07.1993 *i ndryshuar*, ne Marreveshjen Albpetrol me date 26.07.1993, ka te drejten te kryeje operacione hidrokarbure ne Zonen e Kontrates te percaktuar me poshte dhe sipas Licence Marreveshjes me date 30.07.2021 te percaktuar me poshte, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ("MIE") ose "Ministria") i ka dhene Albpetrol-it te drejten ekskluzive te kryeje Operacione Hidrokarbure ne Zonen e Kontratës dhe te hyje në këtë Marreveshje me Kontraktorin;

NDERSA, Albpetroli eshte pale në License Marreveshjen e datës 30.07.2021 dhe

NDERSA, Palet me kete Marreveshje kane rene dakord me kushtet dhe afatet mbi te cilat Kontraktori do ti bashkohet Albpetrolit per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure dhe behet pale ne License Marreveshjen e permendur me siper, dhe per qellime qe lidhen me ate;

NDERSA, Kontraktori ka kapacitet te mjaftueshem kapital, teknik dhe komercial te kerkuar per te kryer ne menyre te suksesshme operacionet hidrokarbure te specifikuara me poshte;

NDERSA, Kontraktori bie dakort te marri persiper detyrimet qe parashikohen ketu dhe me poshte si nje kontraktor ne lidhje me Operacionet Hidrokarbure sikurse percaktohet ne kete Marreveshje; dhe

NDERSA, secila nga Palet ka te drejten, fuqine dhe autoritetin per te hyre ne kete Marreveshje; dhe

NDERSA, Kontraktori, Albpetroli dhe AKBN-ja kane ekzekutuar Instrumentin e Transferimit, me kushtin qe kjo Marreveshje behet efektive ne daten e miratimit te Vendimit perkates te Keshillit te Ministrave;

Ne baze te nje Instrumenti Transferimi sipas formatit bashkengjitur si Aneksi "D" te ekzekutuar nga Palet ne daten e ketij dokumenti, ku MIE vepron nepermjet AKBN-s, Albpetrol i ka transferuar Kontraktorit te drejten e tij per te kryer Operacione Hidrokarbure ne Zonen e Kontrates dhe AKBN e ka miratuar kete transferim per llogari te Ministrise.

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 547, date 9 Gusht 2006, Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore ("AKBN") do te veproje ne emer te Ministrise dhe do te siguroje miratimet dhe autorizimet e nevojshme per realizimin e Operacioneve Hidrokarbure brenda Zones se Kontrates;

BAZUAR NË SA MË SIPËR, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

"**Procedurë Kontabël**" nënkupton procedurën dhe parashikimet sipas Ligjit nr.25/2018 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe te gjithe kuadrit ligjor fiskal dhe tatimor ne fuqi, e përcaktuar në Shtojcën C të kësaj Marreveshje, e cila përbën një pjesë integrale dhe të pandashme të saj.

"Baza e të drejtave dhe detyrimeve të konstatura" nënkupton bazën e kontabilitetit sipas të cilës, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arketohen ose paguhen sipas Kontabilitetit mbi baza monetare) dhe regjistrohen në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.

"Shoqëri e Lidhur" do te thote dhe nënkupton percaktimin ne baze te Ligjit nr.153/2020 "Per regjimin fiskal ne sekotrin hidrokarbur".

"**Shqipëria**" nënkupton Republikën e Shqipërisë.

"Qeveria shqiptare" nënkupton Keshillin e Ministrave te Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë çdo organ ne nivel qendror, ministri, departament, agjenci, nëndarje administrative ose instrumente të saj ose ndonjë autoritet tjetër qeveritar ne Republiken e Shqipërisë.

"**Anekse**" janë të gjitha anekset e kësaj Marreveshje qe jane pjese integrale dhe e pandare e saj dhe kane te njejten fuqi me Marreveshjen.

"**Mjedis**" do te thote dhe nenkupton percaktimin ne baze te Ligjit nr.10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit' *i ndryshuar*.

"Demtim i Mjedisit" do te thote dhe nenkupton percaktimin ne baze te Ligjit nr.10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit' *i ndryshuar*.

"Hidrokarburet e disponueshme" nënkuptojnë sasinë e prodhimit ditor të hidrokarbureve (duke hequr sasinë e humbur, e përdorur në operacione, e djegur ose e ri-injektuar) të prodhuar, të ruajtur dhe të matur nga Zona e Kontratës në Pikën e Matjes. Hidrokarburet e disponueshme mund të jenë Naftë Bruto e disponueshme/ose Gaz i disponueshëm, sipas rastit.

"**Prodhim Mesatar Ditor**" nënkupton prodhimin mesatar të Hidrokarbureve të Disponueshme për çdo Ditë gjatë një Muaji Kalendarik, i cili llogaritet duke pjesëtuar sasinë e përgjithshme të Hidrokarbureve të Disponueshme të matura nga Zona e Kontratës në Pikën e Matjes gjatë atij Muaji Kalendarik, me numrin e ditëve të atij Muaji Kalendarik. Për Muajin Kalendarik, në të cilin përfshihet Data e Prodhimit Fillestar Komercial, hidrokarburet e disponueshme do të pjesëtohen me numrin e Ditëve të atij Muaji Kalendarik pasues, duke përfshirë Datën e Prodhimit Fillestar Komercial.

"**BOE**" janë Fuçi Naftë Bruto Ekuivalent.

"**BOPD**" janë Fuçi Naftë Bruto në Ditë.

"**BPD**" janë Fuçi në Ditë dhe përfshijnë BOPD dhe BOE.

"**BTU**" është një mijë e pesëdhjetë e pesë presje zero pesëdhjetë e gjashtë (1 055,056) Xhaul.

"**Buxhet**" do te thote nje vleresim i perafert i te ardhurave dhe shpenzimeve ne lidhje me nje Program Vleresimi ose nje Program Vjetor.

"**Muaj Kalendarik**" është secili prej dymbëdhjetë (12) muajve të Vitit Kalendarik.

"**Tremujor Kalendarik**" ose "**Tremujor**" është Periudha prej tre (3) Muajsh të njëpasnjëshëm, që fillon në Datën 1 të muajit janar, prill, korrik ose tetor të çdo Viti Kalendarik.

"**Vit Kalendarik**" është Periudha prej dymbëdhjetë (12) Muajsh Kalendarik të njëpasnjëshëm sipas Kalendarit Gregorian, që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor, përfshirë të dyja këto Data.

"**Kontabiliteti mbi bazë monetare**" do të thotë ajo bazë e kontabilitetit sipas të cilës në një periudhë përfshihen vetëm zërat e kostove të cilat janë paguar dhe kanë ndodhur faktikisht dhe të ardhurat që janë arkëtuar faktikisht në atë periudhë."

"**Marreveshje Hidrokarbure**" është kjo Marreveshje, duke përfshirë Anekset e saj me ndryshimet e herëpashershme të miratuara.

"**Zonë Kontrate**" nënkupton në datën e Hyrjes në Fuqi, zonën, kufijtë anësorë dhe thellësinë e saj, siç përshkruhen në Aneksin "A" dhe siç përcaktohen në hartën bashkangjitur si Aneksin "B" të kësaj Marreveshje.

"**Vit Kontraktual**" është Periudha prej dymbëdhjetë (12) Muajsh të njëpasnjëshëm, që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi te kesaj Marreveshje.

"**Kontraktor**" është EDG Natural Gas shpk ose pasardhësi(t) i(e) tij dhe përfituesit e ndonjë Interesi Pjesëmarrjeje, sipas Nenit 16.

"**Hidrokarbure për Mbulimin e Kostos**" nënkupton pjesën e hidrokarbureve të disponueshme të përcaktuar në përputhje me Nenin 9 të kësaj Marreveshje.

"**Gaz natyror**" është gazi metan, përshirë gazin shoqërues, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

"**Naftë Bruto**" janë naftë, asfalte, ozokerite dhe të gjitha llojet e hidrokarbureve e bitumeve, të ngurta dhe të lëngëta, në gjendjen e tyre natyrore ose të fituara nga gazi natyror nëpërmjet kondensimit apo nxjerrjes, por që nuk përfshin qymyrguri apo ndonjë substancë tjetër që mund të nxirret nga qymyrguri.

"**Detyrime Doganore**", sipas përdorimit në këtë Marreveshje , përfshijnë të gjitha taksat, detyrimet, tatimet, tarifat, të drejtat ose çdo detyrim tjetër financiar, që mund të ngarkohen si rezultat i importit ose i eksportit të zërave të përmendur në Nenin 14 të kësaj Marreveshje.

"**Ditë**" ose "**ditë**" është Periudha prej njëzet e katër (24) orësh, që fillon në orën 00:00 dhe përfundon në orën 24:00 (njëzet e katër), me orën shqiptare.

"**Pikë Lëvrimi**" është çdo pikë, brenda territorit te Republikës së Shqipërisë, siç mund të bihet dakord mes Palëve, ku secila Palë merr pjesën e saj përkatëse të Hidrokarbureve për Mbulimin e Kostove dhe të Hidrokarbureve Fitim. Pika e Lëvrimit mund të jetë e njëjtë ose jo me Pikën e Matjes.

"**Zhvillim** nënkupton dhe do të përfshijë, por pa u kufizuar në, të gjitha operacionet dhe aktivitetet në përputhje me Planin e Zhvillimit, Programet e Punës dhe Buxhetet e miratuara sipas kësaj Marreveshje në lidhje me:

i. Shpimin, tamponimin, devijimin, thellimin, kompletimin dhe pajisjen e pusit për qëllimin e Prodhimit dhe ndryshimin e statusit të një pusi të tillë; dhe
ii. Projektimin, ndërtimin, instalimin dhe operimin (brenda ose jashtë Zonës së Kontratës) e pajisjeve; platformave; tubacioneve; sistemeve të ujit, elektrike dhe sistemeve të tjera; strukturat (duke përfshirë strukturat portuale të magazinimit dhe të ngarkimit); strukturat sipas nevojës së prodhimit nga pusi për marrjen, ruajtjen, trajtimin, menaxhimin, magazinimin, djegien, transportimin dhe dorëzimin e Hidrokarbureve për eksport dhe për tregun vendas; dhe për të ndërmarrë injektimin ose riinjektimin dhe projektet e tjera dytësore naftënxjerrjes per prodhimin e hidrokarbureve. Përdorimi i termit "Zhvillim" në këtë Marreveshje do të përfshijë Prodhimin, siç përcaktohet në këtë Marrveshje, në përshtatje me kontekstin dhe rrethanat. Folja "Zhvilloj" nënkupton kryerjen e Zhvillimit.

"**Zone Zhvillimi dhe Prodhimi**" do te thote siperfaqja sic percaktohet ne Planin e Zhvillimit, ne perputhje me Nenin 7.2.1. ose nje Plan Zhvillimi te rishikuar, e percaktuar si e tille nga Kontraktori dhe ne te cilen do te zhvillohen operacione hidrokarbure gjate periudhes se zhvillimit e te prodhimit. Sapo te jete percaktuar, Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit përfshin Zonen e Kontrates sipas Aneksit A.

"**Periudhë Vleresimi**" do te thote periudha gjate te ciles Kontraktori do te zbatoje Programin e Vleresimit, periudhe e cila eshte pershkruar ne Nenin 3.2 te kesaj Marreveshje.

"**Kosto Hidrokarbure**" jane kostot dhe shpenzimet e kryera nga Kontraktori ne lidhje me kryerjen e operacioneve hidrokarbure, sic percaktohen ne kete Marreveshje.

"**Plan Zhvillimi**" është plani i përgatitur nga Kontraktori në përputhje me Nenin 7 të kesaj Marreveshje per zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve ne Zonen e Kontrates.

"**Datë e Hyrjes në Fuqi**" në këtë Marreveshje, do të thotë datë në të cilën hyn në Fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që miraton këtë Marreveshje.
"**Data Efektive**" per qellime te kesaj Marreveshje eshte data e hyrjes ne Fuqi e saj.
"**Ekspert**" nenkupton dhe është një individ/person fizik/entitet juridik, i cili eshte i paanshëm dhe i pavaruar nga palët dhe i cili me anë të trajnimeve dhe eksperiencës së gjerë ka zhvilluar njohuri të posacme, përgatitje, mjeshtëri të thella dhe është specialist në fushën përkatëse në të cilën shtrihet konflikti ose mosmarrëveshja, për të cilën ky ekspert do të jap mendimin/raportin me shkrim për përfundimet e ekspertimit, i cili është emëruar në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marreveshjes.

"**Vit Fiskal**" nënkupton vitin financiar që fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor, duke përfshirë të dyja datat.

"**Forca Madhore**" ka kuptimin që i jepet në Nenin 17 të kësaj Marreveshje.

"**Praktika të Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure**" nënkupton ato praktika, metoda, standarde dhe procedura të pranuara dhe të zbatuara përgjithësisht në shkallë ndërkombëtare nga operatorë të kujdesshëm, të ndërgjegjshëm, të aftë dhe me eksperiencë, në operacionet e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të Hidrokarbureve dhe të cilat, në një moment të caktuar kohe, në zbatim të një gjykimi të arsyeshëm dhe në prani të fakteve të njohura në kohën kur është marrë një vendim, pritet që të arrijnë rezultatet dhe qëllimet e dëshiruara të përcaktuara në lidhje me të cilat, sipas rastit, janë ndjekur praktikat, metodat, standardet, procedurat dhe/ose rregulloret; megjithatë, duke marrë në konsideratë se, "Praktikat e mira ndërkombëtare të industrisë së hidrokarbureve" nuk kanë për qëllim të kufizohen në praktikat ose metodat më të mira, duke përjashtuar gjithë të tjerat, por më shumë duke qenë një spektër i praktikave, metodave, standardeve, procedurave të arsyeshme dhe të kujdesshme dhe/ose i rregullave të sigurisë.

"Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" ose **"SNRF"** nënkupton një sërë parimesh të kontabilitetit të pranuara përgjithësisht të zhvilluara, të mbikëqyrura dhe të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

"Ligjet" nënkuptojnë teresine e akteve normative qe kane fuqi ne territorin e Republikes se Shqiperise, qe perfshijne Kushetuten, marreveshjet nderkombetare te ratifikuara, te gjitha ligjet, aktet normative dhe Vendimet e Keshillit te Ministrave, te organeve te pushtetit vendor, te ministrave dhe organeve drejtuese te institucioneve te tjera qendrore, mbi bazen e te cilave kryhen Operacionet Hidrokarbure dhe gjejne zbatim gjate ushtrimit te te gjithe veprimtarise se Kontraktorit ne Operacionet Hidrokarbure sipas kesaj Marreveshje;

"**LIBOR**" është norma e interesit vjetor e barabartë me normën e interesit të ofruar nga Banka e Shqiperise ose ajo e ofruar në tregun ndërbankar të Londrës (British Bankers Association London Interbank Offered Rate) për depozita njëmujore në dollarë amerikanë, e publikuar në Londër nga Financial Times, ose në Bloomberg.com, ose nëse nuk është e publikuar prej tyre, atëherë ajo e publikuar nga The Wall Street Journal.

"**Sistemi menaxherial i burimeve hidrokarbure (SMBH)**" do te thote dhe perfaqeson nje sistem, i cili eshte realizuar per te arritur nje perkufizim te besueshem dhe te qendrueshem, si dhe klasifikim dhe vleresim te burimeve hidrokarbure.

"EURIBOR" është norma e interesit vjetor e barabartë me normën e interesit të ofruar në tregun ndërbankar te Eurozones.

"Norma bazë e interesit" do te thote dhe percaktohet ne baze te Ligjit Nr 48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore dhe tregtare" *i ndryshuar*.

"**Materiale**" janë makineritë dhe pajisjet e marra për Operacionet Hidrokarbure.

"Furnizimet" jane lendet e para, lendet ndihmese dhe djegese etj, te marra dhe te perdorura per Operacionet Hidrokarbure.

"**MCF**" nënkupton një mijë (1,000) këmbë kub standard (SCF). Një (1) SCF është sasia e gazit të nevojshëm për të mbushur një këmbë kub hapësirë në presion atmosferik prej 14.65 paundë presion për inç katror absolut në një temperaturë bazë prej 60 (gjashtëdhjetë) gradë Fahrenheit.

"**Pikë Matjeje**" vendi apo vendet, te pershkruara ne nje Plan Zhvillimi ku Hidrokarburet maten ne menyre qe te percaktohen volumet e Prodhimit te Disponueshem. Ne çdo rast, Pika e Matjes do te thote pika e percaktuar bashkarisht mes AKBN dhe Paleve, ku do te vendosen instalimet dhe pajisjet perkatese me qellim kryerjen e matjeve volumetrike dhe te tjera te ngjashme, temperatures dhe te ngjashme, percaktimi i permbajtjes se ujit dhe sendimenteve te ngjashme dhe parametrave te tjere te nevojshme per percaktimin e volumeve te hidrokarbureve me qellim realizimin e kushteve te Licence Marreveshjes dhe kesaj Marreveshje. Pika e Matjes mund te jete ose jo e njejte me Piken e Levrimit.

"**Licence Marreveshje**" eshte Licence Marreveshja e hyre ne fuqi me date ____._____. 2021, nje kopje e plote e se ciles i eshte dhene Kontraktorit, ku MIE i ka garantuar Albpetrolit te drejten ekskluzive sipas termave dhe kushteve te percaktuara ne te, qe te kryeje Operacione Hidrokarbure ne Zonen e Marreveshjes dhe te lidhe kete Marreveshje dhe ne te cilen Kontraktori do te behet pale me nenshkrimin e Instrumentit te Transferimit bashkangjitur si Aneks D;

"**MMBTU**" janë një milion (1,000,000) BTU.

"**Muaj**" është Periudha e llogaritur duke filluar nga cilado Ditë e Muajit Kalendarik dhe që përfundon në po të njëjtën Ditë të Muajit vijues Kalendarik, ose në çdo rast tjetër, në Ditën e fundit të Muajit Kalendarik.
"**Operator**" është një subjekt i caktuar nga Kontraktori dhe i miratuar nga Albpetroli dhe AKBN-ja, për të qenë përgjegjës për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në Zonën e Marreveshjes ose në një pjesë të saj, sipas kushteve të kësaj Marreveshje.

"**Palët**" janë Albpetrol Sh.a. dhe Kontraktori, dhe "**Palë**" i referohet secilës nga Palët, duke përfshirë pasuesit përkatës të tyre.

"**Hidrokarbure**" janë naftë bruto dhe/ose gaz natyror, si dhe ato substanca që prodhohen bashkë me to.

"**Operacione hidrokarbure**" janë të gjitha ose çdo operacion që lidhet me kërkimin, vlerësimin e një zbulimi, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen e trajtimin, grumbullimin, transportimin dhe shitjen ose disponimin e hidrokarbureve deri në pikën e eksportit ose në një pikë levrimi në Shqipëri, për të cilën është rënë dakord, ose në pikën e hyrjes në një rafineri dhe përfshin operacionet e përpunimit të gazit natyror, por nuk përfshin operacionet e përpunimit të hidrokarbureve.

"**Operacione te vecanta hidrokarbure**" jane Operacionet Hidrokarbure, qe i perkasin cdo te drejte hidrokarbure, referuar percaktimeve te Nenit 8 te Ligjit Nr.153/2020 "Per regjimin fiskal ne Sektorin Hidrokarbur".

"**Prodhim**" është procesi i nxjerrjes në sipërfaqe të hidrokarbureve, nëpërmjet rrjedhjes natyrale ose nëpërmjet regjimeve artificiale të shfrytëzimit të pusit si cdo operacion tjetër i lidhur me këto procese.

"Hidrokarbure Fitim" është sasia e Hidrokarbureve të Disponueshme, e përcaktuar sipas Nenit 9 të kësaj Marreveshje.

"Rezervuar" është një grumbullim natyror hidrokarburesh, që mund t'i japë ato në kushte të caktuara dhe që zakonisht, karakterizohet nga një sistem hidrodinamik, i vendosur brenda kufijve të një strukture.

"Renta minerare" është taksa e përcaktuar sipas Ligjit nr. 153/2020 "Për Regjimin Fiskal ne Sektorin Hidrokarbur".

"Situacioni i Veprimtarisë së Zhvillimit" është situacioni i përmendur në Aneksin C, pika 2 pjese perberese e kesaj Marreveshje.

"Kosto te aprovuara" nenkuptojne cdo ze i kostove ne nje Situacion te Veprimtarise se Vleresimit dhe Zhvillimit qe konsiderohet perfundimisht e miratuar sipas pikes 3.2 te Aneksit C, pjese perberese e kesaj Marreveshje.

"Kosto te pezulluara" jane kostot e paraqitura ne Situacionin e Veprimtarise se Vleresimit dhe Zhvillimit, qe tregojne shpenzimet e bera dhe te realizuara nga Kontraktori, pergjate periudhes respektive kohore, te kundershtuara nga ana e AKBN-s, te cilat do te perfshihen ne situacionin e mbulimit te kostos dhe do te jene kosto te mbulueshme, deri ne zgjidhjen e ceshtjes/mosmarreveshjes perkates midis paleve, sipas dispozitave te kesaj Marreveshje.

"Kosto të Refuzuara" janë Kostot e Pezulluara per te cilat eshte rene dakord me pas nga AKBN dhe Kontraktori (ose jane vendosur nga eksperti dhe pranuar nga palet apo vendimi i formes se prere te gjykates) te perjashtohen nga mbulimi i kostove sipas kesaj Marreveshje, do te paguhen teresisht nga Kontraktori dhe nuk do te jene kosto te mbulueshme.

"Vit Tatimor" është Periudha dymbëdhjetë (12) mujore sipas Kalendarit Gregorian, që fillon më Datë 1 janar dhe përfundon më Datë 31 dhjetor, përfshirë të dyja këto Data, për të cilat kërkohen raporte dhe pasqyra tatimore, sipas ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme Shqiptare, në lidhje me të ardhurat, fitimet dhe taksa të tjera.

"Zgjidhja e Marreveshjes" është përfundimi i kësaj Marreveshje në mbarim të afatit të zbatueshëm kontraktual, ose në zbatim të dispozitave të Nenit 24, ose me marrëveshje të përbashkët me shkrim mes Palëve.

"Program Vjetor Pune" është Programi i parashikuar në Nenin 8 dhe nga dispozita të tjera të kësaj Marrëveshje dhe, nëse nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, përfshin edhe shtesat dhe ndryshimet e tij.

"Abandonim" eshte largimi perfundimtar i Operatorit nepermjet cmontimit, heqjes dhe/ose asgjesimit te puseve dhe mjeteve/pajisjeve te perdorura per Operacione Hidrokarbure dhe rehabilitimin e tokes rreth nje pusi te abandonuar ne gjendjen sikurse ishte ne kohen menjehere para fillimit te Operacioneve Hidrokarbure ne lidhje me kete pus ose mjet/pajisje sipas parashikimeve te parashikuara ne Nenin 23 te kesaj Marreveshje. Termi "te abandonosh" do te kete kuptimin korrespondues.

"Çmontim" eshte heqja e paisjeve siperfaqesore nga territori i Zones se Operacioneve.

"Kosto Çmontimi" do te thote kostot dhe shpenzimet (pavarsisht te nje natyre kapitale apo operacionale) te kryera ose per tu kryer ne lidhje me Çmontimin / Abandonimin e puseve dhe mjeteve/pajisjeve.

"Plan Çmontimi" do te thote nje plan i pergatitur nga Kontraktori ose dikush i ngarkuar nga Kontraktori per Abandonimin e puseve, mjeteve dhe paisjeve te perdorura per Operacionet Hidrokarbure.

"Zona e Operacioneve te Albpetrolit" do te thote ajo pjese e Zones se Kontrates e cila eshte jashte Zones se Projektit.

"Kondesat" do te thote perzierje kryesisht te perbera nga pentan dhe hidrokarbure me te rende, te prodhuara drejtperdrejt nga rezervuaret hidrokarbure ose te fituara nga kondicionimi i gazit, te cilet jane lengje ne kushte normale te ambjentit, te temperatures dhe presionit atmosferik.

"Te Ardhura te Kontraktorit" do te thote te ardhurat ne para te marra nga Kontraktori si rezultat i shitjes se hidrokarbureve per Mbulim Kosto, sic pershkruhet ne menyre me te plote ne Proceduren Llogaritese.

"Prodhim i Gjykuar" ka kuptimin e dhene ne nenin 3.5 te kesaj Marreveshje.

"Periudhe Zhvillimi dhe Prodhimi" do te thote, ne lidhje me Zonen e Zhvillimit dhe Prodhimit, periudha e specifikuar ne Nenin 3 te kesaj Marreveshje.

"Ministri" eshte ministri pergjegjes per veprimtarine hidrokarbure sipas percaktimeve te Ligjit 7746, date 28.07.1993 "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", *të ndryshuar*.

"Ministria" eshte ministria pergjegjese per veprimtarine hidrokarbure sipas percaktimeve te Ligjit 7746, date 28.07.1993 "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", *të ndryshuar.*

"Zone e Re Vleresimi" ka kuptimin e dhene ne Nenin 3.4.5 te kesaj Marreveshje.

"Program i Ri Vleresimi" ka kuptimin e dhene ne Nenin 3.4.6 te kesaj Marreveshje.

"Zone Projekti" do te thote:

- gjate Periudhes se Vleresimit, ajo pjese e Zones se Kontrates e cila percaktohet here pas here si Zone Vleresimi;
- gjate Periudhes se Zhvillimit dhe Prodhimit, ajo pjese e Zones se Kontrates e cila percaktohet here pas here si Zone Zhvillimi dhe Prodhimi; dhe
- nese Kontraktori ndermerr nje Program Vleresimi te Ri, ajo pjese e Zones se Kontrates e cila percaktohet here pas here si Zona e Re e Vleresimit.

"Studim Mjedisor i nivelit baze", ka kuptimin e dhene ne nenin 20 te kesaj Marreveshje per gjendjen mjedisore.

"**Zona e Kontrates**" dhe "**Zona e Marreveshjes**" kane te njëjtën kuptim.

Neni 2
Qellimi i Marreveshjes, Anekset e Marreveshjes

2.1 Kjo Marreveshje eshte nje renie dakort per kryerjen nga Kontraktori te operacioneve te vleresimit, zhvillimit dhe prodhimit dhe ajo do te mbuloje Operacionet Hidrokarbure ne Zonen e Kontrates. Te drejtat dhe detyrimet e Paleve sipas kesaj Marreveshje do te kene fuqi duke filluar nga Data Efektive. Albpetroli do te njoftoje Kontraktorin per daten e aprovimit nga Keshilli i Ministrave brenda pese (5) dite pune nga data e hyrjes se saj ne fuqi.

2.2 Ne perputhje me termat dhe kushtet e kesaj Marreveshje dhe Nenin 2.3 dhe 2.4, Albpetroli ketu ne menyre te parevokueshme cakton dhe konstituon Kontraktorin ne menyre te vetme dhe ekskluzive per te kryer Operacionet Hidrokarbure ne Zonen e Projektit gjate periudhes te specifikuar ketu, dhe te zgjeroje Zonen e Projektit ne perputhje me kete Marreveshje per te perfshire çdo pjesë toke brenda Zones se Kontrates.

2.3 Ne perputhje me License Marreveshjen, Kontraktori ka te drejte ekskluzive:

(a) te kryeje Operacione Hidrokarbure ne Zonen e Kontrates;

(b) te trajtoje dhe transportoje Hidrokarburet e prodhuara nga Zona e Kontrates;

(c) te ndertoje dhe instaloje te gjitha mjetet dhe paisjet (duke perfshire grumbullimin, trajtimin, tubacionet dhe mjetet e tjera te transportit) te kerkuara per Operacionet Hidrokarbure; dhe

(d) ta perdore per llogari te vet, ta shese brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, shkembeje, te nxjerre ose posedoje Hidrokarburet e prodhuara nga Zona e Kontrates, dhe te marre Fitim nga dhe te titullohet ndaj Hidrokarbureve te prodhuara perveç rasteve kur i nenshtrohet te drejtes se porosise ne kushte emergjence, ose te kontribuoje per te furnizuar tregun lokal sipas çmimeve nderkombetare ne kohen e kerkeses.

Ne përputhje me Liçense Marreveshjen, dhe pavaresisht Nenit 2,3 (a), (b), (c), dhe (d), çdo kontraktor tjeter mund te kryeje operacione hidrokarbure per zhvillimin dhe prodhimin e Hidrokarbureve jashte Zones së Marreveshjes ne perputhje me çdo marreveshje te arritur ndermjet nje kontraktori dhe Ministrise. Ministria, Albpetroli, AKBN-ja dhe Kontratori do te sigurojne qe operacionet hidrokarbure nuk do te interferojne dhe pengojne ne menyre te paarsyeshme zhvillimin normal te Operacioneve Hidroakarbure te Kontraktorit ne Zonen e Kontrates dhe qe as Kontratori nuk do te pengoje ose interferoje me operacionet hidrokarbure te kontraktorit tjetër.

2.4 Albpetroli ka te drejten te kryeje operacione hidrokarbure per llogari te vet ne ndonje pjese te Zones se Kontrates e cila nuk eshte percaktuar si Zona e Projektit deri ne ate kohe kur Kontratori ti kerkoje Albpetrolit te nderprese keto operacione ne rastet kur Kontraktori e përfshin ne Zonen e Projektit ne perputhje me klauzolat e kesaj Marreveshje. Cdo pjese e Zones se Kontrates apo e gjithe Zona e Kontrates mund te zgjidhet nga Kontraktori per t'u bere Zone Vleresimi, nje Zone e Re Vleresimi ose Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit ne perputhje me kete Marreveshje, pavaresisht nese Albpetroli eshte duke kryer operacione hidrokarbure ne kete zone.

2.5 Kontraktori do te jete pergjegjes per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure vetem ne Zonen e Projektit ne perputhje me klauzolat e kesaj Marreveshje, veçmas nga Operacionet Hidrokarbure te kryera nga Albpetroli vetem ne Zonen e Operacioneve te Albpetrolit, nese ka ndonje. Ne perputhje me kete, te drejtat, interesat, detyrimet, pergjegjegjesit dhe çdemtimet e Paleve ne Zonen e Kontrates do te alokohen si me poshte:

Pala	Interesi ne Zonen e Projektit	Interesi ne Zonen e Operacioneve te Albpetrolit
Albpetroli	0%	100%
Kontraktori	100%	0%

Pa paragjykuar pozicionin e Kontraktorit si nje kontraktor këtu dhe më poshtë, masa dhe karakteri i punës që do të bëhet nga Kontraktori do te jete subjekt i rishikimit dhe aprovimit sipas termave dhe kushteve në këtë Marrëveshje.

2.5.1 Secila nga Palet është përgjegjëse veçmas dhe jo bashkarisht per te drejtat, interesat, detyrimet, pergjegjesit, dhe çdemtimet e Kontraktorit siç jepet ne kete Marreveshje; dhe

2.5.2 Kontraktori do te jete pergjegjes sipas Liçense Marreveshjes dhe kesaj Marreveshje veçmas per Operacionet Hidrokarbure e kryera ne Zonen e Projektit, dhe jo ne vend tjeter dhe Albpetroli do të jetë përgjegjës sipas Liçense Marrëveshjes dhe kesaj Marreveshje veçmas per Operacionet Hidrokarbure te kryera ne Zonen e Operacioneve te Albpetrolit, dhe jo ne vend tjeter, duke përfshire pa kufizim;

2.5.2.1 detyrimet që kanë të bëjnë me Abandonimin;

2.5.2.2 pagimin e kostove dhe shpenzimeve të Operacioneve Hidrokarbure;

2.5.2.3 çdemtimet, për dëme të shkaktuara si rezultat i Operacioneve te kryera nga Kontraktori. Kontraktori nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara para Dates Efektive;

2.5.2.4 pergatitjen e Planit te Zhvillimit dhe Programeve Vjetor dhe Buxheteve;

2.5.2.5 Llogaritjen dhe pagesen e Takses mbi Hidrokarburet Fitim ne baze te Ligjit 153/2020 "Per regjimin fiskal ne sektorin hidrokarbur";

2.5.2.6 përputhshmerine me standartet operacionale dhe te mjedisit;

2.5.2.7 pergatitjen e studimeve te nivelit baze;

2.5.2.8 pergatitjen e librave te llogarive, regjistrimeve dhe llogarive te Kostove Hidrokarbure, Hidrokarbureve per Mbulim te Kostove dhe te ardhurave;

2.5.2.9 forces madhore dhe perfundimit te forces madhore; dhe

2.5.2.10 klauzolave te prishjes dhe mbylljes.

Kontraktori do te çdemtoje Albpetrolin nga dhe kundrejt çdo Humbje dhe Detyrimi qe lind nga çdo shkelje nga Kontraktori i ketij Neni 2.5.2, dhe Albpetroli do te çdemtoje Kontraktorin, nga dhe kundrejt çdo Humbje dhe Detyrim qe lind nga çdo shkelje nga Albpetroli i ketij Neni 2.5.3.

2.5.3 Palet bien dakort qe:

2.5.3.1 Cdo pale mund te perdor si instrument garancie vetem pjese te interesit te saj ne Zonen e Kontrates, ne perputhje me afatin e kesaj Marreveshje; dhe

2.5.3.2 Gezimin e lirshem te të drejtave te pronesise te Hidrokarbureve të prodhuara nga Zona e Kontrates per Operacione Hidrokarbure aplikohen vetëm ndaj Hidrokarbureve te prodhuara nga dhe ne Operacionet Hidrokarbure të kryera brenda zonave respektive te interesit të Palëve ne Zonën e Kontratës.

2.6 Per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, Kontraktori do te siguroje gjithe kerkesat teknike dhe financiare dhe do te perdore metoda, procedura, teknologji dhe pajisje pergjithesisht te pranuara ne industrine nderkombetare te naftes.

2.7 Kontraktori do te kryeje Operacione Hidrokarbure ketu dhe me poshte me kosto dhe riskun e vet, po qe se ne kete Marreveshje nuk jepet shprehimisht ndryshe.

2.8 Po qe se ne kete Marreveshje nuk parashikohet ndryshe, ose bihet dakort ndryshe me shkrim, Kontraktori nuk do te marr as kompensim per sherbimet e tij as edhe ndonje rimbursim te shpenzimeve sipas kesaj Marreveshje, pervecse per pjesen e Hidrokarbureve nga Zona e Projektit per te cilen do te titullohet sipas Nenit 9.

2.9 Gjate afatit te kesaj Marreveshje, te gjithe Hidrokarburet e prodhuara nga Zona e Vleresimit dhe ndonje Zone Zhvillimi dhe Prodhimi do te ndahet ndermjet Albpetrolit dhe Kontraktorit ne perputhje me klauzolat ketu.

2.10 Kjo Marreveshje nuk i jep Kontraktorit te drejten e pronesise ndaj Hidrokarbureve ne shtrese ne Zonen e Projektit. Sidoqofte, Kontraktori do te kete te drejten te marre ne natyre, disponoje, shese brenda vendit dhe eksportoje lirshem pjesen e tij te Hidrokarbureve nga Zona e Projektit ne perputhje me klauzolat e kesaj Marreveshje. Kontraktori do te behet pale ne License Marreveshje me nenshkrimin e Instrumentit te Transferimit, i cili eshte nenshkruar nga Albpetroli dhe Kontraktori ne te njejten kohe me nenshkrimin e kesaj Marreveshje.

2.11 Anekset A, B, C, D, E, F dhe G, në këtë Marrëveshje bëhen ketu pjesë e kesaj Marreveshje dhe ato do te konsiderohen qe kane te njejten fuqi dhe efekt me klauzolat e kesaj Marreveshje. Pavaresisht kesaj, ne rast te ndonje konflikti ndermjet Anekseve dhe pjeses kryesore te kesaj Marreveshje, pjesa kryesore e kesaj Marreveshje do te mbizoteroje.

Neni 3
Kohezgjatja

3.1 Nëse nuk zgjidhet në mënyrë të parakohshme në përputhje me kushtet e saj, kjo Marreveshje Hidrokarbure mbetet në Fuqi gjatë Periudhes se Vlerësimit dhe çdo Periudhe Zhvillimi dhe Prodhimi.

3.2 Periudha e Vlerësimit, do të jetë për një kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kesaj Marrëveshje. Nëse do të gjykohet e nevojshme Kontraktori ka të drejtën dhe do të njoftojë me shkrim 30 ditë përpara mbarimit të afatit 18 mujor, edhe 6 (gjashtë) muaj shtesë AKBN-n dhe Albpetrolin.

3.3 Kontraktori mund te zgjedh per te mbyllur kete Marreveshje me perfundimin e Periudhes se Vleresimit, duke njoftuar me shkrim Albpetrolin sipas percaktimeve te Nenit 24.1 te kesaj Marreveshje, shoqeruar me nje kopje tek AKBN. Nese Kontraktori perfundon kete Marreveshje ne menyre te tille, te gjithe

puset, operacionet, asetet (te levizshme apo te palevizshme) do te kthehen tek AKBN-ja ne gjendjen e tyre optimale duke bere dokumentimet perkatese dhe Kontraktori do te çlirohet nga te gjitha përgjegjësite që lidhen me këtë Marreveshje.

3.4 Plani i Zhvillimit

3.4.1 Ne çdo kohe para perfundimit te Periudhes se Vleresimit, por jo me vone se 60 (gjashtedhjete) dite nga dita e mbarimit te Periudhes se Vleresimit, Kontraktori mund te propozoje nje Zonë Zhvillimi dhe Prodhimi per (i) Zonen e Vleresimit dhe (ii) pjese tjeter te tille te Zones se Kontrates te cilen, ne baze te ekperiences gjate Programit te Vleresimit, Kontraktori e gjykon qe mund te jete e pershtatshme per Operacione Hidrokarbure duke respektuar kerkesat e nenit 8 te ligjit 153/2020. Kontraktori do te dorezoje nje Plan Zhvillimi per Zonen e Zhvillimit dhe Prodhimit. Plani i Zhvillimit dhe Prodhimit do te pergatitet mbi bazen e principeve inxhinierike dhe ekonomike me me ze dhe ne perputhje me praktiken pergjithesisht te pranuar te industrise nderkombetare te naftes.

3.4.2 Pas miratimit nga Komiteti Keshillimor, Plani i Zhvillimit do te paraqitet nga Kontraktori per aprovim tek AKBN-ja, per te cilin duhet te shprehet brenda 45 diteve. AKBN-ja mund te kerkoje ndryshime te Planit te Zhvillimit dhe Kontraktori mund te amendoje Planin e Zhvillimit ne pergjigjie te nje kerkese te tille me aprovimin e Paleve.

Nese AKBN nuk shprehet mbi miratimin apo jo te Planit te Zhvillimit brenda 45 diteve nga marrja e tij nga ana e Kontraktorit, atehere Plani i Zhvillimit konsiderohet i miratuar ne heshtje. Nese AKBN nuk e miraton Planin e Zhvillimit pavaresisht se ai reflekton principet inxhinierike dhe ekonomike me me ze ne perputhje me praktiken pergjithesisht te pranuar te industrise nderkombetare te naftes, ne perputhje me klauzolat e License Marreveshjes, palët kete mosmarrëveshje e zgjidhin me percaktim te ekspertit.

3.4.3 Gjate periudhes ne te cilin Plani i Zhvillimit eshte ne pritje per aprovim nga AKBN ose eshte duke u rishikuar nga Kontraktori ne pergjigjie te kerkesave te AKBN-se, Kontraktori mund te vazhdoje operacionet ne Zonen e Vleresimit dhe Zonen e Zhvillimit te ngjashme me ato te kryera gjate Programit te Vleresimit, me kusht qe Kontraktorit nuk i kerkohet te kryeje ndonje shpenzim kapital mbi shumen prej peseqind mije Dollare (500,000 $USD) si angazhim minimal sipas Periudhes se Vleresimit.

3.4.4 Ne cdo kohe gjate zbatimit te Planit te Zhvillimit, Kontraktori mund te propozoje nje rishikim te Planit te Zhvillimit. Keto rishikime mund te perfshijne nje zgjerim te Zones se Zhvillimit dhe Prodhimit per te perfshire siperfaqe ne kontakt me ndonje pjese ekzistuese te Zones se Zhvillimit dhe Prodhimit per tu vleresuar here pas here nepermjet Metodave IOR/EOR, te cilat Kontraktori i propozon per tu ndermarre sipas rishikimit te propozuar te Planit te Zhvillimit, ne perputhje me kufizimin qe Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit nuk mund te zgjerohet me tej, pa miratimin e Albpetrolit dhe AKBN-se, pas pervjetorit te peste te aprovimit fillestar te Planit te Zhvillimit. Cdo rishikim ndaj Planit te Zhvillimit do te pergatitet mbi bazen e principeve inxhinierike dhe ekonomike me me ze dhe ne perputhje me praktikat me te

mira te pranuara ne industrine nderkombetare te naftes dhe do te ndjeki nje proces aprovimi sipas procedures per miratimin e Planit te Zhvillimit.

3.4.5 Gjate zbatimit te Planit te Zhvillimit, Kontraktori mund te propozoje dhe projektoje per aprovim nga Komiteti Keshillimor siperfaqe te reja vleresimi, brenda Zones se Kontrates, por jashte çdo Zone Zhvillimi dhe Prodhimi te propozuar, per nje Periudhe Vleresimi te Re, ne perputhje me kufizimin qe Zona e Projektit nuk mund te zgjerohet me tej, pa miratimin e Albpetrolit dhe AKBN-se pas pervjetorit te peste te aprovimit fillestar te Planit te Zhvillimit. Me aprovim te AKBN-se, per te cilin duhet te shprehet brenda 45 diteve nga paraqitja e propozimit te Kontraktorit per zona te reja vleresimi dhei cili nuk do te kundershtohet ne menyre te paarsyeshme, kjo Periudhe Vleresimi e Re do te kete nje afat fillestar prej 12 muajsh nga fillimi dhe do te perfshije programin perkates te vleresimit ("Programi i Ri i Vleresimit") me vleresim te Kontraktorit. Ne rast se AKBN nuk shprehet brenda ketij afati prej 45 ditesh, atehere siperfaqja e re e vleresimit te propozuar dhe te derguar nga Kontraktori ne AKBN, do te konsiderohet e miratuar ne heshtje. Programi i Ri i Vleresimit do te shtohet tek Aneksi G. Zona e Re e Vleresimit mund të përfshije sipërfaqe brenda Zones se Kontrates ku mund te kryhen aktivitete te reja vleresimi dhe ne vazhdimesi zhvillimi dhe prodhimi. Pas perfundimit te seciles Periudhe Vleresimi të Re duhet dorezuar një shtesei Planit te Zhvillimit ose te hiqet dore nga siperfaqja e re e vleresimit.

3.4.6 Gjate Periudhes se Re te Vleresimit, Kontraktori do te kryeje programe pune minimale dhe angazhime per shpenzime kapitale sic pershkruhet dhe detajohet ne Programin e Ri te Vleresimit, sidoqofte me kushtin qe nese ne perfundim te Periudhes se Re te Vleresimit, ose ndonje zgjatje te saj, ose me mbylljen e kesaj License Marreveshje, cilado qofte qe ndodh e para, Kontraktori ka deshtuar te kryeje ne perputhje me kete Marreveshje, ne total ose pjeserisht programin minimal te punes dhe angazhimit sipas Aneksit C, atehere Kontraktori do ti paguaje AKBN-se nje sasi te barabarte me pjesen e paplotesuar te angazhimit minimal te shpenzimeve kapitale sic parashikohet ne Aneksin C.

3.5 Ne zbatim te Programit te Vleresimit, Planit te Zhvillimit dhe cdo Programi Vleresimi te Ri, Kontraktorit do t'i jepet e drejta te marre cdo pus ekzistues, aset dhe siperfaqe toke ne Zonen e Projektit, pa kompensim, atje ku Albpetroli eshte i titulluar per puse, asete dhe siperfaqe toke te tilla, me kushtin cka parashikohet ne kete klauzole.

Çdo pus i Albpetrolit ne Zonen e Kontrates mund te merret ne dorezim nga Kontraktori ne perputhje me proceduren e marrjes ne dorezim te pershkruar ne Aneksin F. Kur Kontraktori merr në dorëzim ndonje pus ekzistues, aset ose siperfaqe toke dhe Albpetroli nuk është i titulluar për këto, Kontraktori do të jetë përgjegjës për kompensim ndaj paleve të treta për të marre këto te drejta.

Kur kontraktori merre puse te Albpetrolit, kontraktori do ti dorezoje, ne natyre apo ne vlere monetare sic do te biet dokard ndermjet paleve, Albpetrolit Prodhimin e Gjykuar i cili do te llogaritet si me poshtë:

Per cdo pus te mare nga Kontraktori, Prodhimi i Gjykuar per cdo muaj do te jete 70% e mesatares te prodhimit neto te Gazit Natyror te pusit ne gjashte Muajt Kalendarik para

muajit ne te cilen kryhet marrja ne dorezim, dhe renia per cdo muaj pas marrjes ne dorezim mbi bazen e nje renie eksponenciale te prodhimit prej 10 % ne vit.

3.6 Pa kufizuar te drejtat e Paleve sipas Neni 12, ne rast se Kontraktori ndalohet ose pengohet per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure ose per te hyre ne Zonen e Kontrates per arsye qe lidhen me mbrojtjen e personelit, nenkontraktoreve, ose pasurise, ose per probleme te importimit te pajisjeve dhe jashte kontrollit te Kontraktorit, detyrimet e Kontraktorit sipas kushteve ketu dhe me poshte do te pezullohen nga koha e fillimit te kesaj ndalese/pengese, per te cilen eshte bere njoftimi perkates derisa kjo ndalese/pengese te mos ekzistoje. Per kete ceshtje, Kontraktori do te kryeje menjehere nje njoftim me shkrim prane Albpetrol dhe AKBN, me ane te te cilit do te argumentoje faktet, arsyet dhe kohen ne te cilen kane ndodhur keto te fundit, qe e pengojne/ndalojne ne kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure. Pas kesaj, por sa me shpejt qe te jete e mundur, palet do te takohen dhe bien dakort per nje periudhe kohe e cila duhet shtuar ne Periudhen e Vleresimit dhe cdo Periudhe Zhvillimi dhe Prodhimi, periudhe kohe e cila duhet te jete e barabarte me periudhen e kohes se nevojshme per te rivendosur Operacionet Hidrokarbure ne gjendjen ne te cilen ato ishin ne kohen e ndaleses/pengeses.

3.7 Kontraktori mund të zgjedhe te mbyll kete Marreveshje ne çdo kohe te Periudhes se Zhvillimit dhe Prodhimit duke njoftuar Albpetrol dhe AKBN-n me shkrim. Mbyllja do te marr efekt nëntëdhjetë (90) dite pas dorëzimit të njoftimit nga ana e Kontraktorit. Nese Kontraktori mbyll këtë Marrëveshje në mënyre të tillë, të gjithe puset, operacionet, dhe asetet (e luajtshme dhe te paluajtshme) do te kthehen tek AKBN-ja dhe Kontraktori do te clirohet nga te gjitha pergjegjesite ne lidhje me kete Marreveshje pervec detyrimeve sipas kesaj Marreveshje, te cilat jane vendosur para mbylljes, duke perfshire pa kufizim ndonje detyrim per mjedisin dhe abandonimin sipas kesaj Marreveshje dhe License Marreveshje. Nese Kontraktori anullon ose dorezon Marreveshjen Hidrokarbure gjate nje viti kalendarik te Periudhes se Zhvillimit dhe Prodhimit ne te cilin aplikohet nje Program Vjetor dhe Buxhet i aprovuar, te gjitha garancite e vendosura nga Kontraktori, nese ka te tilla, do te kalojne ne favor te Albpetrolit.

3.8 Periudha e Zhvillimit dhe Prodhimit do te vazhdoje deri ne perfundimin e 25 (njezet e pese) viteve nga data e miratimit te Planit te Zhvillimit. Me perfundimin e Periudhes se Zhvillimit dhe Prodhimit, Kontraktori ka te drejte qe ne perputhje me License Marreveshjen te kerkoje nga AKBN-ja dhe Albpetrol nje zgjatje te Periudhes njezet e pese (25) vjecare te Zhvillimit dhe Prodhimit per nje periudhe pese (5) vitesh suksesive me te njejtat kushte sic jepet këtu, ku keto te fundit nuk do ta refuzojnë në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 4
Heqja dore

4.1 Kontraktori mund te heqe dore vullnetarisht ne cdo kohe nga te drejtat e tij per te kryer Operacione Hidrokarbure ne gjithe ose cdo pjese te Zones se Kontrates, ne te cilen jane kryer Operacione Hidrokarbure, Kontraktori do te marre te gjitha hapat e nevojshem per te rehabilituar cdo ndikim negativ te konsideruar mbi mjedisin te shkaktuar nga Operacionet Hidrokarbure minimalisht deri ne gjendjen fillestare qe ishte kur eshte marre ne dorezim. Asnje heqje dore nuk do ta cliroje Kontraktorin nga angazhimet e tij minimale te paplotesuar per nje Program Vleresimi.

4.2 Te pakten tridhjete dite (30) dite para dates te nje heqje dore sipas Nenit 4.1, Palet do te njoftojne AKBN-ne per pjesen e Zones se Kontrates nga e cila do te hiqet dore.

4.3 Ne daten qe ndonje heqje dore eshte efektive, me njoftimin prane AKBN-se ose ne mbyllje te kesaj Marreveshje, Kontraktori nuk do te kete te drejta ose detyrime te tjera ne lidhje me siperfaqen nga e cila eshte hequr dore.

4.4 Pranohet që, si rezultat i heqjeve dore në përputhje me këtë Nen 4, Zona e Zhvillimit dhe Prodhimit mund të perbehet prej me shume se një siperfaqe jo të vazhduar.

Neni 5
Kryerja e Operacioneve

5.1Komiteti Keshillimor

5.1.1 Per qellim te nje zbatimi sic duhet te kesaj Marreveshje, Palet do te ngrene nje Komitet Keshillimor ("Komiteti Keshillimor") brenda 30 (tridhjete) diteve nga Data Efektive. Komiteti Keshillimor do te kete detyrat e parashtruara ne Nenin 5.1.5.

5.1.2 Albpetroli dhe Kontraktori do te caktojne secili nga tre (3) perfaqesues dhe perfaqesues alterantive per te formuar Komitetin Keshillimor dhe secila Pale do te percaktoje njerin prej perfaqesuesve te tij si kryetar te perfaqesuesve te tij. Te gjithe perfaqesuesit ne fjale do te kene te drejten per te paraqitur pikepamjet e tyre mbi propozimet ne takimet e mbajtura nga Komiteti Keshillimor dhe te deklarojne voten e tyre kur ndonje vendim eshte per tu marre. Kryetar i Komitetit Keshillimor do te jete kryetari i perfaqesuesve i caktuar nga Albpetroli dhe nen-kryetar do te jete kryetari i perfaqesuesve i caktuar nga Kontraktori. Kryetari i Komitetit Keshillimor do te kryesoje takimet e Komitetit Keshillimor. Secili perfaqesues do te kete nje vote ne te gjitha takimet e Komitetit Keshillimor. Ne perputhje me nevojen, Palet mund te caktojne nje numer te arsyeshem pjesemarres shtese te cilet do te ndjekin, por nuk do te titullohen per te votuar ne takimet e Komitetit Keshillimor. Secila Pale do ti njoftoje pales tjeter emrat e perfaqesuesve te saj brenda tridhjete (30) diteve nga Data Efektive dhe do te njoftoje me shkrim ne rast te ndonje zevendesimi te ndonje prej ketyre perfaqesuesve. Perfaqesuesit alternativ do te zevendesojne perfaqesuesit kryesor ne mungese te ketyre te fundit.

5.1.3 Me qëllim që të jete i vlefshem, çdo vendim që kërkohet për t'u marre nga Komiteti Keshillimor duhet të ketë vote miratuese të te pakten pese (5) përfaqësuesve të pranishem ne takim pavaresisht personalisht ose me video konference. Asnje vendim i tille nuk do të jetë i vlefshem nëse të pakten dy (2) përfaqesues te Albpetrolit dhe Kontraktorit nuk janë prezent në takim, ose fizikisht ose me video konference. Në fund të çdo takimi të Komitetit Këshillimor, vendimet e marra nga Komiteti Keshillimor do te regjistrohen dhe firmosen nga te gjithe anetaret pjesëmarrës te Albpetrolit dhe te Kontraktorit.

Kontraktori do të përgatise protokollin e takimit brenda tridhjete (30) diteve dhe do t'ja dergoje atë per miratim Paleve. Mos pergjigjia nga nje Pale brenda njezet e nje (21) diteve nga marrja dijeni do te gjykohet si nje aprovim ne heshtje nga nje Pale e tille.

5.1.4 Komiteti Këshillimor do të mbahet te pakten dy here ne cdo Vit Fiskal dhe kur te kerkohet nga Albpetroli ose Kontraktori, i kushtezuar me nje njoftim paraprak prej 15 ditesh tek anetaret e tij, njoftim i cili do te perfshije axhenden për takimin.Vendime

mund të merren nga Komiteti Keshillimor nëpërmjet nje rezolute me shkrim te firmosur nga të peste (5) përfaqesuesit ose perfaqesuesit alternativ te tyre.

5.1.5 Sipas kësaj Marrëveshje, Komiteti Keshillimor do të ketë funksionet dhe përgjegjësitë si më poshtë:

5.1.5.1 Të siguroje mundesine dhe te inkurajoje shkembimin e informacionit, pikepamjeve, ideve dhe sugjerimeve ne lidhje me planet, performancen dhe rezultatet e fituara sipas Marreveshjes;

5.1.5.2 Te shqyrtoje principet e ngritura nga Kontraktori here pas here per te drejtuar aspekte ose aktivitete te ndryshme te Operacioneve Hidrokarbure dhe te propozoje per kete qellim, procedura dhe udhezime siç mund te gjykohen te nevojshme;

5.1.5.3 Te shqyrtoje dhe aprovoje Programet Vjetore te propozuara nga Kontraktori per Periudhen e Zhvillimit dhe Prodhimit, dhe te propozoje rishikime ne perputhje me Nenin 8.3;

5.1.5.4 Te shqyrtoje Programet Vjetore dhe Buxhetet e propozuara nga Kontraktori per Periudhen e Vleresimit dhe cdo Periudhe te Re Vleresimi;

5.1.5.5 Te shqyrtoje dhe aprovoje Zonat e Zhvillimit dhe Prodhimit dhe Planin e Zhvillimit qe Kontraktori, ne emer te Paleve, planifikon te propozoje tek AKBN-ja per aprovim prej saj;

5.1.5.6 Te bashkepunoje per zbatimin e Programeve Vjetore dhe Buxheteve dhe Planit te Zhvillimit; dhe

5.1.5.7 Të shqyrtoje dhe aprovoje Planin e Abandonimit, Planin e Punes dhe Buxhetit per Abandonimin;

5.1.5.8 Te shqyrtoje dhe aprovoje Planin e Çmontimit, Planin e Punes dhe Buxhetit per Çmontimin;

5.1.5.9 Funksione te tjera te tilla qe do ti besohen me miratim nga Palet.

5.1.6 Sidoqofte, ketu bihet dakort midis Paleve qe vendimet e meposhtme i rezervohen dhe behen vetem nga Kontraktori:

5.1.6.1 Vendndodhjen, shpimin, testimin, kompletimin, marrjen ne dorezim te puseve per ri-kompletim dhe abandonim te çdo pusi, pavaresisht se eshte per prodhim te Gazit apo per Operacione Hidrokarbure te tjera, duke perfshire pa kufizim programet, metodologjine dhe teknologjine qe do te perdoret ne kryerjen e aktiviteteve te mesiperme;

5.1.6.2 Programet Vjetore dhe Buxhetet gjate Periudhes se Vleresimit; dhe

5.1.6.3 Siperfaqet per heqje dore sipas kesaj Marreveshje.

5.2 Operatori

5.2.1 Nese Kontraktori perbehet nga me shume se nje Kompani, Kontraktori ka te drejten te zgjedhe nje Kompani te veproje si Operator, i cili do te kryeje Operacionet Hidrokarbure ne Zonen e Projektit në përputhje me legjislacionin Shqiptar te zbatueshem, termat dhe kushtet e kësaj Marreveshje dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të vendburimeve të naftës dhe gazit.

EDG Natural Gas shpk caktohet si Operator prej Dates Efektive.

5.2.2 Emerimi i nje Operatori pasardhes te Operatorit qe eshte permendur ketu do te jetë subjekt i aprovimit paraprak te AKBN-s dhe Albpetrol-it, aprovim i cili nuk do te kundershtohet ne menyre te paarsyeshme, me kusht qe nuk kerkohet nje aprovim i tille dhe vetem njoftim me shkrim duhet te jepet nese Operatori pasardhes eshte nje Kompani ose eshte nje Filial i nje Kompanie ne ate kohe.

Neni 6
Periudha e Vleresimit

6.1 Kontraktori do të kryejë Periudhën e Vlerësimit. Nëse në përfundim të tetembedhjet(18)/njëzet e katër (24) muajve, sa do te zgjate Periudha e Vleresimit sipas kesaj Marreveshje, ne vijim te Dates Efektive, Kontraktori deshton te shpenzoje 500,000 (pesëqind mije) $USD per kryerjen e aktiviteteve qe perbejne Periudhen e Vleresimit, atehere Kontraktori do ti paguajë AKBN-s nje shume te barabarte me pjesen e pa-realizuar te angazhimit financiar minimal te Periudhes se Vleresimit, sic specifikohet ne Aneksin G.

Ne rast vonese te pageses se demshperblimit, për t'ju paguar AKBN ne aplikim te ketij Neni 6.1, pjesa e parealizuar e angazhimit financiar minimal, do te mbarti interes te llogaritur nga data perfundimtare ne te cilen detyrimet duheshin paguar dhe deri ne kohen kur pagesa behet nga Kontraktori, me normen baze te interesit, e percaktuar ne baze te Ligjit Nr 48/2014, 'Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore dhe tregtare" *i ndryshuar*.

6.2 Kontraktori ka te drejte te shpenzoje me shume se 500,000 (pesëqind mije) $USD dhe te shtrije Programin e Vleresimit për të përfshirë pune dhe aktivitete shtesë në puse shtese brenda Zones se Projektit nese ai zgjedh te veproje kështu gjatë Periudhes se Vlerësimit.

Neni 7
Zhvillimi dhe Prodhimi

7.1 Plani i Zhvillimit do te pergatitet mbi bazen e principeve inxhinierike, mjedisore dhe ekonomike me me ze ne perputhje me praktiken pergjithesisht te pranuar te industrise nderkombetare te naftes dhe gazit.

7.2 Plani i Zhvillimit do te permbaje, por pa u kufizuar:

7.2.1 Detajet dhe shtrirjen e siperfaqes te Zones se Zhvillimit dhe Prodhimit te propozuar; vëllimet e përllogaritura të naftës dhe/ose gazit që gjenden fillimisht në shtresë dhe sasinë e përllogaritur si të rikuperueshme, mënyrën e parashikuar të operimit dhe efiçencën e rikuperueshmërisë, hapësirën e drenimit, politikën e parashikuar për shfrytëzimin e rezervuarit dhe objektin e rikuperimit dytësor;

7.2.2 Propozime ne lidhje me rrjetin, shpimin dhe kompletimin e puseve, instalimet e prodhimit dhe grumbullimit, dhe pajisjet e transportit dhe levrimit të kërkuara për prodhimin, grumbullimin dhe transportin e Gazit Natyror;

7.2.3 Propozime në lidhje me investimet për infrastrukturën e nevojshme;

7.2.4 Nje parashikim të prodhimit dhe një vlerësim të investimeve dhe shpenzimeve të përfshira;

7.2.5 Nje vleresim te kohës së kërkuar për të perfunduar cdo faze te Planit te Zhvillimit;

7.2.6 Piken e Levrimit dhe Piken e Matjes te propozuar.

Albpetroli mund ti kerkoje Kontraktorit qe te jape informacion te tille shtese sic mund te jete pa vështiresi i disponueshem dhe sic mund te kete nevoje në mënyre të arsyeshme për të vlerësuar Planin e Zhvillimit për Zonën e Zhvillimit dhe Prodhimit. Kjo kërkesë per infomacion duhet te behet brenda njezet (20) ditësh nga marrja e Planit të Zhvillimit dhe Kontraktori do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të kthyer përgjigjie brenda tridhjetë (30) diteve nga marrja dijeni.

7.3 Nese AKBN-ja nuk kerkon me shkrim ndonje ndryshim ndaj Planit te Zhvillimit brenda dyzet e pese (45) diteve pas dorezimit te Planit te Zhvillimit ose Planit te Zhvillimit te rishikuar sic eshte aprovuar nga Palet, Plani ose Plani i amenduar do te gjykohet i aprovuar nga AKBN-ja.

7.4 Nese AKBN-ja kerkon ndonje ndryshim ndaj Planit te Zhvillimit, atehere Palet dhe AKBN-ja do te takohen brenda pesembedhjete (15) diteve te marrjes nga Kontraktori te njoftimit me shkrim prej AKBN-se ne lidhje me keto ndryshime te kerkuara dhe do te perpiqen ne mirebesim te arrijne nje marreveshje mbi Planin e Zhvillimit. Nese bihet dakort brenda nje periudhe tjeter prej tridhjete (30) ditesh, ndryshimet e kerkuara perfshihen ne Planin e Zhvillimit, atehere ky plan do te gjykohet i aprovuar nga AKBN-ja.

Nese nuk arrihet marreveshje, secila Pale mund te kerkoje qe ceshtja t'i kaloje eksperteve sipas parashikimeve te Nenit 19 te kesaj Marreveshje. Vendimi i eksperteve per kete çështje nuk eshte i detyrueshem per palet.

Nese Kontraktori deshiron te amendoje materialisht Planin e Zhvillimi te aprovuar nga AKBN-ja, ai duhet ti japi AKBN-se amendimet e propozuara ne perputhje me procedurat e parashtruara ne kete Neni 7.4.

7.5 Pasi Plani i Zhvillimit te jete aprovuar, te pakten nentedhjete (90) dite para fundit te secilit Vit Fiskal, Kontraktori do te paraqese ne Komitetin Keshillimor nje deklarate te detajuar te Programit Vjetor dhe Buxhetit per Vitin Fiskal pasardhes ne lidhje me Zonen e Zhvillimit dhe Prodhimit.

Per Vitin Fiskal te pare te plote dhe per pjesen e Vitit Fiskal para Viti Fiskal te pare te plote, si rezultat do te paraqitet ne AKBN brenda gjashtedhjete (60) diteve pas dates se aprovimit te Planit te Zhvillimit sipas Neneve 7.3 ose 7.4, nje deklarate e detajuar e Programit Vjetor dhe Buxhetit. Secila deklarate e tille vjetore e Programit Vjetor dhe Buxhetit do te jete ne perputhje me Planin e Zhvillimit te aprovuar sipas Nenit 7.3 ose sic rishikohet ne perputhje me Nenet 7.4 dhe 7.6.

7.6 Palet ne cdo kohe mund te paraqesin ne AKBN per aprovim, rishikime ndaj Planit te Zhvillimit ose Programit Vjetor dhe Buxhetit. Keto rishikime do te jene ne perputhje me klauzolat e Nenit 7.1 dhe ne rastin e rishikimeve te Planit te Zhvillimit do te jene subjekt i procedures se aprovimit dhene ne Nenin 7.3 dhe 7.4, dhe ne rastin e Programit Vjetor dhe Buxhetit te shqyrtimit sic jepet ne Nenin 5.1.5.3.

7.7 Kur Albpetroli dhe Kontraktori bien dakort qe mund te arrihet nje perfitim ekonomik reciprok duke ndertuar dhe operuar pajisje te perbashketa (duke perfshire, por pa u kufizuar ne rruge, tubacione dhe pajisje transporti, komunikimi dhe grumbullimi), Albpetroli dhe Kontraktori do te perdorin perpjekje te arsyeshme per te arritur marreveshje njeri me tjetrin dhe nese do te jete e nevojshme me prodhues te tjere mbi ndertimin dhe operimin e ketyre pajisjeve te tilla te perbashketa, rikuperimin e investimeve dhe pagesat qe duhen bere.

Neni 8
Programet Vjetor dhe Buxhetet

8.1 Po qe se nuk jepet ndryshe ketu, Kontraktori do te filloje kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure per puset e pershkruara ne Aneksin F, jo me vone se dhjete (10) dite pasi Albpetroli ti njoftoje Kontraktorit qe Marreveshja Hidrokarbure eshte aprovuar nga Keshilli i Ministrave. Procedura per transferimin e aseteve, operacioneve dhe pergjegjesive qe lidhen me keta puse dhe pajisjet e lidhur me ata do te jete sic pershkruhet ne Aneksin F.

8.2 Brenda gjashtedhjete (60) diteve pas Dates Efektive, Kontraktori paraqet tek Albpetrol dhe AKBN nje Program Vjetor dhe Buxhet duke parashtruar Operacionet Hidrokarbure te cilat Kontraktori i propozon per tu kryer gjatë Periudhes së Vlerësimit. Ne perputhje me Nenin 6.3, ky Program Vjetor dhe Buxhet do te jete konsistent me Programin e Vleresimit, por me gjykim te Kontraktorit, ai mund te perfshije me shume aktivitete dhe buxhet sesa Programi minimal i punes per periudhen e Vleresimit. Gjate Periudhes se Vleresimit nuk kerkohet as aprovimi i Albpetrolit dhe as i Komitetit Keshillimor per ndonje Program Vjetor dhe Buxhet. Kontraktori mund te kerkoje amendimin e Programit Vjetor dhe Buxhetin gjate Periudhes se Vleresimit per aq kohe sa ky Program Vjetor dhe Buxhet i rishikuar perfshine te pakten aktivitetet dhe buxhetin kapital te

Programit te Vleresimit. Nje kopje e secilit Program Vjetor dhe Buxhetit do ti jepet nga ana e Kontraktorit Albpetrolit dhe AKBN-se.

8.3 Të paktën nëntëdhjetë (90) dite para fundit të Vitit Fiskal të parë pas aprovimit te Planit te Zhvillimit dhe çdo Vit Fiskal pas tij, Kontraktori do të pergatisë dhe dorëzojë në Komitetin Këshillimor për aprovim një Program Vjetor dhe Buxhet te propozuar per Vitin Fiskal pasardhes. Cdo Program Vjetor dhe Buxhet do te jete konsistent me Planin e Zhvillimit. Nëse përfaqesuesit e Albpetrolit ne Komitetin Keshillimor kane propozime për të rishikuar disa vecori specifike te Programit Vjetor dhe Buxhetit ne fjale, duhet ta bëjnë brenda njezet e nje (21) diteve pas marrjes nga Komiteti Keshillimor dhe te njoftoje Kontraktorin, duke specifikuar me detaje arsyet e tij për këtë. Menjëhere pas kesaj, Palët do te takohen jo me vonë se pesembedhjete (15) dite dhe do te perpiqen te bien dakort mbi rishikimin e propozuar nga perfaqesuesit e Albpetrolit. Propozimet e Albpetrolit per rishikimin e cdo Programi Vjetor dhe Buxheti do te jene ne perputhje me Planin e Zhvillimit, dhe cdo rishikim i propozuar ndaj nje Programi Vjetor dhe Buxheti qe jane ne perputhje me Planin e Zhvillimit duhet te pranohet nga Kontraktori. Ne rast te lindjes se ndonje konflikti ne lidhje me aprovimin e nje Programi Vjetor dhe Buxheti, palet perpiqen qe ta zgjidhin ate me mirekuptim. Ne rast se zgjidhja me mirekuptim deshton, ceshtja do te çohet per zgjidhje tek Ekspertet ne perputhje me parashikimet e Nenit 19. Para zgjidhjes te cdo konflikti te tille, Programi Vjetor dhe Buxheti i propozuar nga Kontraktori, do te gjykohet i aprovuar per qellime operacionesh te brendshme gjate zgjidhjes.

8.4 Palet bien dakort te drejtojne Komitetin Keshillimor per te aprovuar Programin Vjetor dhe Buxhetin ne nje kohe te pershtateshme ne menyre te tille qe te lejojne dergimin e Programit Vjetor dhe Buxhetit te propozuar per tek AKBN-ja brenda periudhes se kohës të përcaktuar ne këtë Marreveshje dhe License Marreveshje.

8.5 Pranohet nga Palet qe detajet e nje Programi Vjetor dhe Buxheti mund te kerkojne ndryshime ne varësi te kushteve ekzistuese dhe ne kete menyre Kontraktori mund ti beje keto ndryshime me kusht qe ato nuk ndryshojne objektivin e pergjithshem te Programit Vjetor dhe Buxhetit. Cdo rishikim ndaj Programit Vjetor dhe Buxhetit qe sjell nje pershpejtim te aktiviteteve qe janë te parashikuara nga Plani i Zhvillimit, ose qe zgjeron aktivitetet qe parashikohen nga Plani e Zhvillimit, do te aprovohen nga Komiteti Keshillimor. Ne perputhje me kete Marreveshje, nje kopje e Programit Vjetor dhe Buxhetit do te dergohet tek AKBN-ja, e cila duhet ti miratoje ato brenda 30 diteve.Ne rast se AKBN nuk shprehet brenda 30 diteve per miratim, atehere Programi Vjetor dhe Buxheti do te konsiderohen te miratuar ne heshtje.

8.6 Pranohet me tej se ne rast emergjence, që kerkon veprim të menjëhershëm, Kontraktori mund të marrë te gjitha veprimet qe ai i gjykon te përshtatshme qe mbrojne interesat e tij dhe ato te punonjesve te tij dhe cdo kosto që kërkohet për këtë qëllim do të përfshihet ne Kostot per Operacione Hidrokarbure. Nje gjendje emergjence do te ekzistoje kur jeta, shendeti, ose pasuria rrezikohen nga kushtet ekzistuese ose kushte potenciale te tilla si fontanime, zjarre, eksplozione, kushte serioze moti, akte lufte. Pas zbutjes se gjendjes se emergjences Kontraktori organizon nje mbledhje te Komitetit Keshillimor me qellim informimin e tij per gjendjen e emergjences, situaten dhe zgjidhjet e propozuara. Njekohesisht, nese gjendja e emergjences ka sjelle shtim te shpenzimeve qe ndikojne esencialisht Buxhetin e miratuar te atij viti, Kontraktori paraqet per miratim shtesen e Buxhetit qe ka ardhur si pasoje e gjendjes se emergjences ku Kontraktori duhet te

vertetoje bazuar ne fakte dhe prova se keto situata emergjente nuk jane shkaktuar per faj te tij, shtese kjo qe nuk do te refuzohet ne menyre te paarsyeshme.

Neni 9
Pjesa e Albpetrolit, Hidrokarbure Fitim dhe Rikuperimi i Kostove

9.1 Kontraktori do të sigurojë të gjitha fondet e kërkuara për te kryer Operacionet Hidrokarbure sipas kesaj Marreveshje. Kontraktori do te kete te drejten te perdore gazin natyror te prodhuar nga Zona e Projektit, pa pagese, ne masen qe eshte parashikuar ne Programin Vjetor dhe Buxhetin per Operacionet Hidrokarbure sipas kesaj Marrëveshje.

9.2 Hidrokarburet per Mbulim Kosto do te jene ne masen 84 % e hidrokarbureve te Disponueshme minus pjesen e Albpetrolit (ASP-Albania Share Production dhe Prodhimin e Gjykuar). Pjesa tjeter do te konsiderohet hidrokarbur fitim dhe do te taksohet me Tatim Fitimi sipas legjislacionit ne fuqi.

Pjesa e fitimit qe i mbetet Kontraktorit pas pageses se Tatim Fitimit do te dale nga librat e llogarive qe mbahen per efekt te Faktorit R dhe /ose Tatim Fitimit.

Trasferimi dhe/ose ndarja e prodhimit do të shoqërohet nga palët me faturë tatimore të fiskalizuar, sipas Ligjit 87/2019 "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit dhe Qarkullimit"

9.3 Gazi Natyror i Disponueshme do të matet në Pikën e Matjes dhe do të alokohet sic jepet në këtë Marrëveshje. Gazi Natyror i Disponueshem do të alokohet ndërmjet Albpetrolit ("Pjesa e Albpetrolit") dhe Kontraktorit ("Kontraktori") bazuar ne Faktorin R.

Koeficienti R llogaritet si më poshtë:

$$R_N = \frac{A_K}{B_K}$$

Ku:

R_N - nënkupton faktorin R për tremujorin kalendarik N;

A_K – nënkupton shumën e të ardhurave të kontraktorit minus tatimin mbi fitimin të akumuluar gjatë tremujorit kalendarik N, si dhe gjatë periudhave të mëparshme kalendarike pas datës efektive;

B_K – nënkupton shumën e kostove të Gazit Natyror në tremujorin kalendarik N, si dhe të gjithë tremujoreve kalendarike të mëparshëm pas datës efektive.

Pjesa e Prodhimit të Albpetrol ("ASP") të Gazit Natyror në dispozicion, do të ndryshojë në varësi të vlerës së Faktorit R, si më poshtë:

Faktori R	Pjesa e Albpetrolit	Kontraktori
$0.0 < R \leq 1.0000$	2%	98%
$1.0000 < R \leq 1.5000$	5%	95%
$1.5000 < R < 2.0000$	7%	93 %

Pjesa e Albpetrolit do te terhiqet ne natyre ose vlere monetare, sic palet do te bien dakord rast pas rasti.

9.4 Percaktimi i Faktorit R fillimisht do te behet per Tremujorin Kalanderik te pare ne vijim te Dates Efektive.

9.5 Kontraktori do te titullohet per Gazin per Mbulim Kostoje per te rikuperuar te gjitha Kostot Hidrokarbure te mbartura nga ai brenda ose te lidhura me Zonen e Projektit ("Rikuperim i Kostos"). Kostot Hidrokarbure do te jene sic pershkruhen ne Aneksin C.

Pasi Kontraktori ka rikuperuar te gjitha Kostot Hidrokarbure te tij nga Gazi per Mbulim Kostoje, pjesa e Gazit per Rikuperim Kostoje e mbetur do te jete "Hidrokarbur Fitim".

9.6 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj Marreveshje që është e kundërt me këtë, Prodhimi Mesatar Ditor nuk do të përcaktohet derisa gjithë tubacionet, apo pjesët e tyre, që kërkohen për marrjen e Hidrokarbureve para apo pas Pikës së Matjes të jenë mbushur dhe presuar me sasinë e duhur te Hidrokarbureve ("Line Fill"). Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakort me shkrim për kohën kur mund të disponohet Line Fill dhe mund të përfshihet në Prodhimin Mesatar Ditor.

Neni 10
Bonuset e Trajnimit, Prodhimit dhe Nenshkrimit

10.1 Kontraktori do te shpenzoje 20 000 (njezet mije) Dollar Amerikan per cdo vit kontraktual per qellime trajnimi te punonjesve te autoritetve shqiptare ose per qellime administrative ne varesi te kerkeses se Ministrise. Kontraktori do ti paguaje Albpetrolit bonusin e trajnimit dhe administrativ tridhjetë (30) ditësh pas fillimit të çdo Viti Kontraktual të Periudhës së Vleresimit dhe Prodhimi. Në rast se këto periudha nuk fillojnë që në fillim ose nëse nuk përfundojnë në fund të një Viti Kontraktual të plotë, kjo shumë do të përllogaritet proporcionalisht.

10.2 Kontraktori do t'i paguajë Albpetrol-it Bonuset e Prodhimit si më poshtë:

a) Brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës në të cilën Prodhimi mesatar Ditor i Gazit Natyror nga Zona e Kontratës, gjatë një periudhe prej nëntëdhjetë (90) Ditësh të njëpasnjëshme, arrin 50 000 Nm^3/dite pesedhjete mije normal metër kub Gaz Natyror në ditë, Kontraktori i paguan Autoriteteve Shqiptare, një Bonus Prodhimi prej pesedhjete mijë dollarë amerikanë (50 000 USD).

b) Brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës në të cilën Prodhimi mesatar Ditor i Gazit nga Zona e Kontratës gjatë një periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditësh të njëpasnjëshme arrin njëqind e shtatedhjetë mijë 170 000 Nm^3/dite normal metër kub Gaz Natyror në ditë Kontraktori do t'i paguajë Autoriteteve Shqiptare një Bonus Prodhimi, prej shtatëdhjetë e pese mijë dollarë amerikanë (75 000 USD).

c) Brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës në të cilën Prodhimi mesatar Ditor i Gazit nga Zona e Kontratës gjatë një periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditësh të njëpasnjëshme arrin peseqind mijë 500 000 Nm^3/dite normal metër kub Gaz, Kontraktori do t'i paguajë Autoriteteve Shqiptare një Bonus Prodhimi, prej njeqind mijë dollarë amerikanë (100 000 USD).

10.3 Kontraktori do t'i paguaje Albpetrolit brenda 10 (dhjete) diteve pas dates efektive shumen prej pesedhjete mije dollare amerikane 50,000 $US si nje bonus nenshkrimi. Bonusi i nenshkrimit nuk do te perfshihet si kosto e rikuperushme.

10.5 Kontraktori është i lirë të zgjedhë punonjësit e tij dhe të përcaktojë numrin e tyre, për t'i përdorur në Operacionet Hidrokarbure në kuadër të kësaj Marreveshje, në përputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe legjislacionin ndërkombëtar te ratifikuar nga Republika e Shqiperise.

Neni 11
Titujt ndaj Aseteve

11.1 **Pasuria e luajtshme.**

11.1.1 Ne baze te License Marreveshjes, titujt ndaj aseteve ne posedim te Kontraktorit ne lidhje me Operacionet Hidrokarbure, do te transferohen tek AKBN-ja ne kohen qe kostot e ketyre aseteve te paluajtshme dhe te luajtshme jane rikuperuar plotesisht si Kosto Hidrokarbure, ose ne kohen e mbylljes ose heqjes dore prej Operacioneve Hidrokarbure, cilado qe ndodhe e para, te gjitha keto asete qe jane ne kushte te mira pune, te konsumuara ne nje shkalle normale te pranueshme. Sidoqofte, Kontraktori mban te drejten e perdorimit te plote dhe lirshem te aseteve te permendura me lart gjate afatit te kesaj Marreveshje, duke perfshire ato te instaluara para Dates Efektive.

Çdo aset i luajtshem mund t'i shitet nje pale te trete me aprovim paraprak te AKBN-se, aprovim i cili nuk do te kundershtohet ne menyre te paarsyeshme. Per kete qellim, Kontraktori do ti drejtohet me nje kerkese me shkrim AKBN-s, e cila duhet te shpreh miratimin e saj brenda 30 ditesh. Pas miratimit nga AKBN-ja, do te ngrihet nje komision prej 3 vetash nga ana e Kontraktorit, i cili do te beje vleresimin e asetit per shitje, duke marre ne konsiderate gjendjen faktike dhe vleren e tregut ne momentin e vleresimit. Kontraktori do te njoftoj AKBN per diten dhe oren e hapjes se ofertave, qe te mundesohet marre pjese si vezhgues per ndjeken e procedures. Ne rast se AKBN nuk shprehet mbi kete kerkese brenda 30 ditesh, atehere konisderohet e miratuar ne heshtje.Te ardhurat nga shitja e çdo aseti do te konsiderohen si te Ardhura per Mbulim Kostosh.

11.1.2 Pavaresisht Nenit 11.1.1 me siper, bihet dakort posaçerisht qe çdo aset qe i perket nje pale te trete ose Filialeve dhe i marre me qira nga Kontraktori per qellime te Operacioneve Hidrokarbure dhe çdo aset i zoteruar nga nen-kontraktoret ose Filialet e tyre, nuk do te behen pasuri e AKBN-së. Vlera e këtyre aseteve nuk do te llogariten si kosto hidrokarbure.

11.2 **Pasuria e paluajtshme**

11.2.1 Te Dhenat Origjinale

Me mbylljen e kesaj Marrveshjeje, Kontraktori do te dorezoje tek AKBN-ja te gjitha te dhenat origjinale. Te gjitha keto te dhena origjinale (duke perfshire por pa u kufizuar ne ato sizmike, gjeofizike, gjeologjike, gravimetrike, magnetometrike, karrotazhe, shpimin, prodhimin, ndertimin, projektimin, etj.) do te behen pasuri e Qeverise Shqiptare.

Kontraktori do te furnizojë Albpetrolin me keto te dhena mbi nje baze te vazhdueshme.

Sidoqofte, Kontraktori, ose marresit e interesave te tij, do te titullohen per te mbajtur dhe perdorur lirshem kopje te ketyre te dhenave dhe per rrjedhoje do tu jepet nje autorizim/miratim, jo ekskluziv dhe pa pagese, per perdorim te te dhenave ne fjale.

11.2.2 Te Dhenat e Interpretuara

Te dhenat e Interpretuara mbi bazen e te dhenave Origjinale te referuara ne seksionin 11.2.1 me siper, pavaresisht se jane krijuar nga Kontraktori, nga Filialet e tij ose pale te treta me shperblim te Kontraktorit, do te mbeten e vetmja pasuri e Kontraktorit dhe sipas Nenit 23 te Marreveshjes do te konsiderohet si informacion konfidencial.

Sidoqofte, Albpetroli eshte i titulluar te marrë kopje te te gjithe raporteve perfundimtare ne lidhje me te gjitha te dhenat e krijuara ne kuadër te zbatimit te këtaj Marreveshje dhe t'i perdori ato vetem per nevojat e tij. Albpetrolit duhet ti jepen keto te dhëna nga Kontraktori 1 muaj pas krijimit te tyre.

Neni 12
Te Drejtat dhe Detyrimet e Paleve

12.1 Prej Dates Efektive, Kontraktorit do t'i jepet e drejta te perdori:

(a) Ne menyre ekskluzive, pa pagese gjithe mjetet dhe pajisjet ne Zonen e Kontrates per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure per:

(i) zbatimin e Operacioneve te Vleresimit si dhe Operacioneve te Zhvillimit dhe Prodhimit;

(ii) aplikimin e Metodave IOR/EOR ne te gjithe Zonen e Kontrates dhe ne perputhje me kushtet dhe termat e kesaj Marreveshje; dhe

(iii) Prodhimin e Hidrokarbureve ne Zonen e Projektit,

por pa cenuar materialisht operacionet e Albpetrolit jashte Zones se Projektit;

(b) Pa pagese, per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, gjithe asetet, paisjet, mjetet dhe infrastrukturen tjeter (duke perfshire rruget, linjat e furnizimit me energji dhe uje, tubacionet e naftes dhe gazit) qe ekzistojne ne Zonen e Marreveshjes, si dhe ne perputhje me pagesen, mbi nje baze jo-diskriminuese dhe bazuar ne rregullat ne fuqi, me kosto te arsyeshme per elektricitet, uje, nafte dhe gaz te perdorur;

(c) te gjitha te dhenat teknike te disponueshme ne AKBN qe kane te bejne me Zonen e Kontrates me kusht qe Kontraktori do te rimbursoje AKBN per te gjitha kostot e arsyeshme te kryera per pergatitjen e transferimit te ketyre te dhenave dhe koston per berjen kopje te ketyre te dhenave.

12.2 Kontraktori do te kete te drejten gjate kohezgjatjes se kesaj Marreveshje te eksportoje ose te tregtoje ne tregun vendas te gjithe ose nje pjese te prodhimit te Hidrokarbureve.

12.3 Kontraktori do te siguroje te gjitha fondet e nevojshme dhe do te mbarte te gjitha kostot dhe shpenzimet e kerkuara per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas kesaj Marreveshje, pervecse ne masen sic jepet ndryshe ne kete Marreveshje.

12.4 Kontraktori do te perpiqet te arrije perdorim eficient dhe zhvillim te sigurte per prodhimin e hidrokarbureve dhe te optimizoje nxjerrjen ekonomike perfundimtare te hidrokarbureve nga Zona e Projektit. Kontraktori do t'i kryeje Operacionet Hidrokarbure ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, mbi mbrojtjen e mjedisit dhe ne perputhje me rregulloret e nxjerra ne zbatim te ketij legjislacioni dhe ne perputhje me praktikat e mira ne industrine e naftes.

12.5 Kontraktori do te siguroje qe gjithe materialet, paiisjet, mjetet e perdorura ne Operacionet Hidrokarbure te perputhen me normat inxhinierike pergjithesisht te pranuara, dhe te mbahen ne nivel optimal pune.

12.6 Kontraktori do te bleje ose marrë me qira te gjitha paisjet, materialet, sherbimet dhe furnizimet e kerkuara per t'u blere ose marre me qira ne perputhje me Programin Vjetor.

12.7 Kontraktori do te informoje Albpetrolin me te gjitha aktivitetet qe do te kryhen sipas kesaj Marreveshje dhe do ta furnizoje Albpetrolin

(a) me raporte javore te prodhimit te vleresuar te Gazit;

(b) raporte mujore mbi prodhimin e Gazit dhe Operacionet Hidrokarbure;

(c) raporte tremujor mbi Kostot e Gazit.

12.8 Kontraktori do te lejoje perfaqesuesit e Albpetrolit te inspektojne ne te gjitha kohet e arsyeshme Operacionet Hidrokarbure sipas kesaj Marreveshje.

12.9 Kontraktori do te mbaje te gjitha regjistrimet origjinale te gjithe Operacioneve teknike te Hidrokarureve sipas kesaj Marreveshje per nje periudhe jo me pak se njezet e kater (24) muaj. Kostot e kryera per kete jane plotesisht te pagueshme si Kosto Hidrokarbure.

12.10 Albpetroli dhe AKBN-ja do te sigurojne qe Kontraktori, ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi:

(a) te kryeje Operacionet Hidrokarbure ne perputhje me kete Marreveshje, dhe

(b) te prodhoje, transportoje, te shese brenda dhe jashte vendit te gjithe ose nje pjese te prodhimit sic jepet ne kete Marreveshje dhe Ligjin Hidrokarbure.

12.11 Albpetrol dhe AKBN do te sigurojne, brenda kompetences se tyre, qe Kontraktorit i jane dhene ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, te gjitha te drejtat, lejet, licensat, aprovimet dhe autorizimet e tjera qe ai mund te kerkoje ne menyre te arsyeshme me qellim qe te kryeje Operacionet Hidrokarbure ne perputhje me kete Marreveshje dhe qe çdo kompensim i cili mund te kerkohet per tu paguar nga Kontraktori, do te jete ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

12.12 Albpetroli dhe AKBN-ja do t'i vene ne dispozicion Kontraktorit gjithe te dhenat teknike qe disponohen nga Albpetroli ose AKBN-ja ne lidhje me Zonen e Kontrates, me kusht qe Kontraktori do te rimbursoje Albpetrolin ose AKBN-ne per te gjitha kostot e aresyeshme te kryera per pergatitjen e transferimit te ketyre te dhenave dhe koston per kopjimin e ketyre te dhenave.

12.13 Kontraktori do te rezervojë dhe mbaje çdo kampion dhe shllam shpimi te marre nga shpimi i pusit ne menyren, vendin dhe kohen e percaktuar nga Albpetrol dhe AKBN-ja me rregullore te vecante. Te gjitha kampionet e marra nga Kontraktori per qellime te veta do te konsiderohen subjekt per tu inspektuar nga AKBN-ja ne cdo kohe qe AKBN-ja e kerkon, brenda kohes zyrtare te punes. Ne perputhje me kete parashikim, Kontraktori do te jete i lire te eksportoje kampion (karotier) dhe shllame per analiza jashte vendit.

12.14 Kontraktori do te jete i lire te eksportoje origjinalet e regjistrimeve te te dhenave teknike jashte vendit, ne perputhje me aprovimin e AKBN-se dhe me kushtin qe nje regjistrim i monitorizuar ose i krahasueshem eshte mbajtur nga Kontraktori ose Albpetroli ne Shqiperi. AKBN do ta jap kete miratim brenda 10 diteve nga paraqitja e kerkeses nga ana e Kontraktorit, ne rast te kundert konsiderohet e miratuar ne heshtje.

12.15 Palet pranojne qe natyra e te drejtave dhe detyrimeve te tyre respektive sipas kesaj Marreveshje ne lidhje me Zonen e Marreveshjes eshte e tille qe unifikimi i siperfaqeve qe jane te gjitha teresisht brenda Zones se Marreveshjes nuk kerkohet per te mbrojtur te drejtat respektive te Paleve ose per te ruajtur ose optimizuar nxjerrjen e Hidrokarbureve nga Zona e Marreveshjes.

Neni 13
Tatimet dhe Taksat Shqiptare

13.1 Kontraktori do te paguaje te gjitha taksat qe i ngarkohen atij bazuar ne veprimtarine e tij, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

13.2 Secili prej subjekteve që përbën Kontraktorin, siç mund të rezultojë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marreveshje, i nënshtrohet pagesës së tatimit shqiptar mbi fitimin, në përputhje me Ligjin nr. 153/2020 "Për Regjimin Fiskal ne Sektorin Hidrokarbur" dhe me dispozitat e Nenit 9 te kesaj Marreveshje. Tatimi mbi fitimin, në Fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marreveshje, është në normën pesëdhjetë për qind (50%) të zbatueshme në pjesën e tij të Hidrokarbureve Fitim.

13.3 Kontraktori do të paguajë Rentën Minerare dhe tatimin mbi fitimin, siç përshkruhet më sipër. Secila prej subjekteve qe perbejne Kontraktorin dhe nenkontratoret e tyre do te përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar ne përputhje me ligjin nr. 92/2014, Datë 24.7.2014 "Për TVSH-në", *i ndryshuar*.

13.4 Kontraktori do të përmbushë kërkesat e legjislacionit në lidhje me depozitimin e deklaratave tatimore, lëshimin e faturës së fiskalizuar, vlerësimin tatimor dhe mbajtjen tatimeve/taksave ne burim si dhe mbajtjen e librave dhe regjistrave kontabël konform kërkesave te ligjislacionit kontabël dhe atij tatimor, per t'u kontrolluar nga personat e autorizuar.

Neni 14
Importet dhe Eksportet

14.1 Kontraktori dhe nen-kontraktoret e tij te angazhuar ne kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas kesaj Marreveshje do te lejohen te importojne, paisjet, makinerite, materialet, etj. qe do te perdoren per kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas kesaj Marreveshje, ne përputhje me legjislacion shqiptar ne fuqi.

14.2 Megjithate, Kontraktori dhe nen-kontraktoret e tij do ti japin prioritet mallrave dhe materialeve te prodhuara ne Shqiperi, nese keto mallra dhe materiale ofrohen sipas kushteve te favorshme e te barabarta ne lidhje me cilesine, çmimin dhe disponibilitetin dhe ne sasite e kerkuara.

Neni 15
Librat Kontabël, Kontabiliteti dhe Pagesat

15.1 Kontraktori do të mbajë në Zyrat e tij në Shqipëri llogarite kontabël në përputhje me praktikat e kontabilitetit sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, Standardet Kombetare dhe Ndërkombëtare te Kontabilitetit si dhe praktikave të kontabilitetit përgjithësisht të pranuara, të cilat zbatohen në industrinë e naftës dhe gazit natyror, legjislacionin dhe dispozitat e Marreveshjes, si dhe regjistrat e të dhënat e tjera të cilat janë të nevojshme për të treguar punimet e kryera në përputhje me këtë Marreveshje, duke përfshirë shumën e të gjithë Hidrokarbureve të Disponueshme. Kontraktori do të mbajë librin e tij të llogarive dhe regjistrimet kontabël në monedhën shqiptare Lek.

15.2 Të gjitha shpenzimet e kryera në monedhën shqiptare Lek do të regjistrohen në librat e Kontraktorit në kolonën e shumës së shpenzuar. Kontraktori do të lejohet të ketë dhe t'i përdorë lirisht llogaritë bankare në Dollarë jashtë territorit të Shqipërisë dhe në Shqipëri për qëllimet e kryerjes së veprimeve të tij në përputhje me këtë Marreveshje. Për qëllime të kësaj Marreveshje, Kontraktori gëzon liri të plotë të marrë dhe të mbajë jashtë vendit, si dhe të administrojë lirisht valutat e huaja të marra nga jashtë vendit, përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e Hidrokarbureve në përputhje me këtë Marreveshje, si dhe Kontraktori nuk do të jetë i detyruar t'i mbajë këto të ardhura në Shqipëri, me përjashtim të të ardhurave, të cilat sipas mendimit të tij, do t'i duhen për të përballuar shpenzimet që mund të ketë në Shqipëri.

15.3 Librat e lartpërmendur të llogarive, librat e tjerë dhe regjistrimet e referuara më lart do të mbahen në gjuhën shqipe, si dhe do të vihen në dispozicion, në çdo kohë të arsyeshme, me qëllim që të kontrollohen nga përfaqësuesit e autorizuar të Albpetrolit, AKBN-së dhe autoriteteve tatimore shqiptare.

15.4 Kryerja e të gjitha pagesave që Kontraktori i detyrohet Albpetrol-it dhe AKBN-së në përputhje me këtë Marreveshje, do të bëhen ekskluzivisht me transfertë bankare në llogarinë(të) e hapura në emër të Albpetrolit dhe AKBN-së në Shqipëri. Kontratori do të kryejë pagesat Albpetrolit dhe AKBN-së kundrejt faturës së fiskalizuar.

Neni 16
Transferimi i Interesave

16.1 Kontraktori do te mund te transferoje tek ndonje Person, plotesisht ose pjeserisht ndonje prej te drejtave, privilegjeve, detyrave dhe detyrimeve sipas kesaj Marreveshje me aprovim paraprak me shkrim nga Albpetrol dhe AKBN, aprovim i cili nuk do te kundershtohet ose vonohet ne menyre te paarsyeshme jo me vone se brenda 30 diteve nga paraqitja e kerkeses nga ana e Kontraktorit. Ne rast se Albpetrol apo AKBN nuk shprehet brenda ketij afati, kerkesa konsiderohet e miratuar ne heshtje. Cdo Personi, te cilit i transferohen keto te drejta, privilegje, detyra dhe detyrime do te jete teknikisht dhe financiarisht kompetent, dhe ky transferim nga nje pikepamje tjeter duhet te perputhet me kerkesat e Nenit 16.3. Ministria per shkak te sigurise kombetare, mund te refuzoje transferimin e kuotave te Marreveshjes Hidrokarbure.

16.2 Pavaresisht Nenit 16.1, por ne perputhje me kerkesat e Nenit 16.3, Kontraktori do te jete i lire te transferoje te drejtat, privilegjet, detyrat dhe detyrimet e tij sipas kesaj Marreveshje tek nje Filial pas perfundimit te njoftimit paraprak me shkrim prej gjashtedhjete (60) dite te bere tek Albpetroli per kete transferim, me kusht qe Kontraktori siguron nje garanci me shkrim per performance te plote nga ky Filial per te gjitha detyrat dhe detyrimet qe jane per tu transferuar sipas kesaj Marreveshje. Ne cdo kohe ne vijim te nje transferimi te tille, Kontraktori i meparshem qe ka bere kete transferim mund te kerkoje qe Albpetrol-i te mos kerkoje me garancine e meparshme, dhe kjo kerkese nuk do te refuzohet ose vonohet ne menyre te paarsyeshme nga Albpetroli duke treguar qe, Filiali te cilit i eshte bere ky transferim posedon ne menyre te pavarur kompetence teknike dhe financiare per te kryer plotesisht detyrat dhe detyrimet te cilat jane transferuar tek ai. Cdo transferim nga Kontraktori tek nje Filial pa garancine me shkrim te meparshme nga Kontraktori do te jete ne perputhje me kerkesat e Nenit 16.1.

16.3 Ne lidhje me transferimin e te drejtave, privilegjeve, detyrave dhe detyrimeve sipas kesaj Marreveshje, do te plotesohen kushtet e meposhtme:

(a) Detyrat dhe angazhimet e ndermarra nga ana e Kontraktorit do te plotesohen plotesisht deri ne daten kur eshte bere kerkesa per aprovim, ose Kontraktori do te garantoje, bashkarisht ose vecmas me Perfituesin e Interesit, kryerjen e cdo detyrimi i cili nuk eshte plotesuar qe prej kesaj date.

(b) Personi te cilit i behet transferimi do ti paraqesi Albpetrol-it dhe AKBN-s deshmi te arsyeshme te kompetences se tij teknike dhe/ose financiare; dhe

(c) Instrumenti i Transferimit duhet te perfshije klauzola te cilat ne menyre te qarte te deklarojne qe Kontraktori eshte pergjegjes per te gjitha angazhimet e permbajtuara ne kete Marreveshje dhe cdo modifikim ose amendim me shkrim qe mund te jete efektiv deri ne daten e transferimit dhe duhet deklaruar me tej qe Kontraktori nuk ka ndonje pretendim per ndryshim te termave te kesaj Marreveshje si nje kusht per transferimin. Instrumenti i Transferimit do te jete subjekt per tu rishikuar dhe aprovuar nga AKBN dhe nuk do te kundershtoje ose vonoje ne menyre te paarsyeshme kete aprovim.

16.4 Kontraktori mund ti perdor si instrument garancie te drejtat sipas kesaj Marreveshje per qellim te rritjes se financimit te Operacioneve Hidrokarbure, me miratim paraprak

me shkrim nga Albpetroli, miratim i cili nuk do te kundershtohet ose vonohet ne menyre te paarsyeshme brenda 30 diteve nga paraqitja e kerkeses nga ana e Kontraktorit. Ne rast se AKBN nuk shprehet brenda ketij afati, atehere kjo kerkese do te konsiderohet e miratuar ne heshtje.

16.5 Me transferimin e te gjitha te drejtave, privilegjeve, detyrave dhe detyrimeve te tij tek nje Person tjeter, ne perputhje me kete Nen 16, Kontraktori me berjen e transferimit do te pushoje te kete ndonje te drejte/interes dhe detyrime ne kete Marreveshje si Kontraktor.

16.6 Pavaresisht sa përcaktohet ne kete nen, Ministria, për shkak të sigurisë kombëtare, mund të refuzojë transferimin e interesave të kesaj Marrëveshje Hidrokarbure.

Neni 17
Forca Madhore

17.1 Forca Madhore është një ngjarje që është përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës së prekur, që njëkohësisht pengon dhe vonon këtë Palë të prekur të përmbushë të gjitha apo një pjesë të detyrimeve të saj që burojnë nga kjo Marreveshje (me përjashtim të pagesave me para në dorë).

Ngjarja e Forcës Madhore është një ngjarje absolutisht dhe objektivisht e pamundur për t'u parandaluar apo për t'u shmangur nga Pala e prekur;

Ngjarja e Forcës Madhore është një ngjarje që nuk ka ardhur si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së detyrimeve të kësaj Marreveshje nga Pala e prekur.

17.2. Për qëllime të kësaj Marreveshje, Forca Madhore përfshin pa kufizim ngjarjet e mëposhtme:

i. rrethanat e shkaktuara nga kushte jashtëzakonisht të këqija të motit dhe fatkeqësi natyrore, duke përfshirë epidemitë, stuhitë e fuqishme, tërmetet, përmbytjet, zjarrin, ciklonet/uraganet/tajfunet/tornadot/stuhitë e emërtuara, bllokimet nga bora, ngrirjen e detit, dhe/ose fatkeqësi të tjera natyrore;
ii. lufta (e shpallur ose jo), grevat lokale dhe kombetare, kërcënime lufte, konflikti i armatosur ose kanosje serioze për një konflikt të tillë, bllokadat, embargot ushtarake, mobilizimi i përgjithshëm ushtarak, veprime ushtarake, lufta, Pushtimet, kryengritjet ushtarake;

17.3. Në rrethana të Forcës Madhore, Pala e prekur duhet të njoftojë Palën tjetër brenda tridhjetë (30) ditësh për arsyet e vonesës së përmbushjes së detyrimeve, për të gjetur një mënyrë për të zbutur efektet e forcës madhore dhe për të vazhduar zbatimin e kesaj Marreveshje.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të përdoren si shkak për pretendime për dëmshpërblim ose për përmbushje të detyrimeve te kesaj Marreveshje.Kufijtë për përmbushjen e detyrimeve do të vendosen me marrëveshje mes Palëve.

17.4 Pasojat e Forcës Madhore në Marreveshje

Me fillimin e ngjarjes së Forcës Madhore, detyrimet e Palës së prekur pezullohen për të gjithë kohëzgjatjen e ngjarjes së Forcës Madhore. Kjo periudhë kohe i shtohet Periudhës së Vleresimit/Zhvillimit, bashkë me Periudhën kohore të nevojshme për rikthimin e Operacioneve Hidrokarbure në gjendjen që ishin në momentin që filloi ngjarja e Forcës Madhore.

Kontraktori i prekur nga Forca Madhore ka të drejtë të zgjidhë kete Marreveshje:

i. Në rast se pas zbatimit të pikës 17.2 të këtij Neni, nuk është gjetur një zgjidhje në favor të projektit.
ii. Kur Forca Madhore zgjat më shumë se 6 muaj.

Kontraktori gëzon të drejtën të zgjidhë këtë Marreveshje duke i dhënë Albpetrol-it njoftim me shkrim tridhjetë (30) Ditë para, dhe kështu ai shkarkohet nga të gjitha detyrimet që ka sipas kësaj Marreveshje. Me kusht qe asnjë përfundim nuk do ta cliroje Kontraktorin nga ndonjë angazhim apo obligim i papermbushur dhe i mbartur përpara Forces Madhore.

17.5. Pasojat e zgjidhjes së kesaj Marreveshje për shkak të Forcës Madhore. Në rastin e zgjidhjes së kesaj Marreveshje për shkak të Forcës Madhore, Palët nuk kanë asnjë detyrim apo përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit, dhe secila nga Palët mbulon Kostot e veta.

17.6. Ne asnje rast mungesa e fondeve nga Kontraktori nuk do te perbejne rast te Forces madhore.

Neni 18
Legjislacioni i Zbatueshem

18.1 Kjo Marreveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore shqiptare te zbatueshme ne fushen hidrokarbure (veçanërisht nga Legjislacioni për Hidrokarburet dhe Legjislacioni Fiskal për Hidrokarburet) dhe legjislacioni ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqiperise.

18.2 Të drejtat dhe detyrimet e Albpetrol dhe Kontraktorit sipas kësaj Marreveshje dhe për kohën që kjo Marreveshje është në fuqi, do të rregullohen nga dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marreveshje dhe mund të ndryshohen vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim te nenshkruar nga nga Palët.

18.3 Nënkontraktorët e Kontraktorit u nënshtrohen të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në fuqi si dhe ndryshimeve te tyre të herë pas hershme.

18.4 Në rast se ndonjë dispozitë, ndryshim apo amendament i ri i ligjeve apo rregulloreve shqiptare apo ndonjë ndryshim në interpretimin e tyre, i vendos Kontraktorit detyrime, tatime, të drejta, pagesa apo detyrime të tjera të reja apo diskriminuese, për sa u përket atyre që shprehimisht konsiderohen të zbatueshme për mbajtësin e së drejtës hidrokarbure e tij sipas kushteve të kësaj Marreveshje dhe qe nuk ekzistojne ne daten e hyrjes ne fuqi te kesaj Marreveshje dhe që per Kontraktorin kanë ndikim negativ për të, duke përfshirë përfitimin e pritshëm ekonomik sipas kësaj Marreveshje prej Datës së Hyrjes së saj në Fuqi, atëherë do te zbatohen parashikimet e pikes d)

Nenit 5 te Ligjit 7746, date 28.07.1993 "Per hidrokarburet" *i ndryshuar* dhe Palët e kesaj Marreveshje do të marrin masa për ndryshimin e saj me kërkesë të Kontraktorit dhe te nenit 18 te ligjit nr.153/2020 "Per regjimin fiskal ne Sektorin Hidrokarbur".

18.5 Nëse natyra e dispozitave, ndryshimeve, amendamenteve të reja apo interpretimi i përmendur më sipër, e bëjnë të pamundur praktikisht modifikimin e përqindjeve të ndarjes së fitimit, të përmendura në Nenin 9, Albpetrol, AKBN-ja dhe Kontraktori do të bien dakord për ndonjë metodë tjetër për të kompensuar Kontraktorin për barrën shtesë të ngarkuar mbi Kontraktorin, me kusht që kjo metodë alternative të ruajë ekuilibrin ekonomik të kësaj Marreveshje, sikur të mos kishin ndodhur këto ndryshime apo amendamente.

Neni 19
Mosmarrëveshjet dhe Zgjidhja e tyre

19.1 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mënyrë miqësore**

19.1.1 Në rast të ndonjë pretendimi, ndryshimi ose mosmarrëveshjeje (këtu e më poshtë referuar si "Mosmarrëveshja") mes Paleve e lindur nga, dhe e lidhur me këtë Marreveshje, ose veprimet apo aktivitetet e kryera sipas kësaj Marreveshje, përfshirë të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me ndërtimin vlefshmërinë, interpretimin, zbatimin mosrespektimin, mbarimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marreveshje, Palët do të përpiqen fillimisht t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore përmes negociatave, të cilat nuk duhet ta tejkalojnë periudhën e 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim që njëra palë i dorëzon Palës tjetër lidhur me ekzistencën e kësaj mosmarrëveshjeje.

19.1.2 Në rast se mosmarrëveshjet subjekt i negocimit sipas këtij Neni nuk jane zgjidhur përmes negociatave brenda periudhës së përmendur më lart, secila Palë, duke njoftuar me shkrim Palën tjetër, mund të propozojë se Mosmarrëveshja të zgjidhet ose përmes vendimit të Ekspertit sipas pikes 19.2 ose përmes Gjykates Kompetente sipas pikes 19.3.

19.2 **Vendimi i Eksperteve**

19.2.1 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në Nenin 9, të gjitha çështjet që janë subjekt mosmarrëveshjeje midis paleve, të cilat lidhur me këtë Marreveshje do t'i referohen Eksperteve, zgjidhja e tyre do të kërkohet përmes vendimit të Eksperteve, te cilet duhet te plotesojne kerkesat si me poshte:

-Ekspertit do ti referohen per zgjidhje vetem ceshtje te natyres teknike dhe jo ceshtje qe lidhen me interpretimet juridike te Marreveshjes;
-Te percaktohen afatet kohore brenda te cilit palet do te dakordesojne detyrat e percaktuara per ekspertet;
-Nese fillon nje procedure zgjidhje me ekspert, palet e kane te ndaluar te procedojne ne te njejten kohe me zgjidhjen e mosmarreveshjeve ne gjykate;
-Plaet nese nuk bien dakord me vendimin e ekspertit kane te drejte ti drejtohen gjykates kometente.

Ekspertet e caktuar duhet te kene njohur dhe ekspertize te thelluar sipas objektit/natyres se mosmarreveshjes, perfshire por pa u kufizuar, ne fushen e industrise se naftes dhe gazit, eksperience mbi rregullat nderkombetare dhe vendase te administrimit te industrise se naftes dhe gazit, karakteristikave te zhvillimit te kesaj industrie dhe problematikes qe karakterizon Republiken e Shqiperise ne kete fushe. Keta te fundit do të njihen me detyrat e percaktuara nga palet per ekspertet, të cilat do të përcaktohen bashkërisht mes Palëve. Ekspertet do të caktohen me marrëveshje mes Paleve. Në rast se palet nuk arrijnë ta caktojnë Ekspertet brenda tridhjetë (30) ditëve pas rënies dakord për detyrat qe duhet tu percaktohen eksperteve, atehere palet do ti drejtohen Gjykates kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjes. Ekspertet do të japin vendimin e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Marreveshje, bazuar në provat më të mira që i janë vënë në dispozicion. Përfaqësuesit e AKBN-së apo Albpetrolit dhe Kontraktori do të kenë të drejtën të konsultohen me Ekspertet duke u vënë këtyre të fundit në dispozicion të gjitha të dhënat dhe informacionet, me kusht që Ekspertet të vendosin kufizime të arsyeshme mbi këtë të drejtë. Këto të dhëna dhe informacione duhet t'i dorëzohen në të njëjtën kohë edhe Palës tjetër në konflikt. Ekspertet do të jenë te lirë të vlerësojnë shkallën sipas së cilës të gjitha të dhënat, informacionet ose provat e tjera provohen ose kanë lidhje me çështjen. Tarifat, shpenzimet dhe kostot e Eksperteve do të mbulohen nga Palet. Vendimi i Eksperteve nuk do të jetë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për Palët.

19.2.2 Do të jenë gjithsej tre (3) Eksperte. Pala që ka nisur zgjidhjen e mosmarreveshjes me ekspert do të caktojë një ekspert dhe Pala që përgjigjet do të caktojë një expert tjetër. Në rast se Pala që do të përgjigjet, nuk arrin të zgjedhë një ekspert brenda tridhjetë ditëve (30), atëherë Pala që nis proceduren do ti drejtohet Gjykates Kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjes . Të dy (2) ekspertet e emëruar do të zgjedhin ekspertin e tretë, i cili do të mbajë postin e kryetarit ekspert.

19.3 **Gjykata Kompetente**

19.3.1 Të gjitha konfliktet, mosmarrëveshjet ose pretendimet që lindin nga ose në lidhje me këtë Kontratë, ose veprimet e kryera sipas kësaj Marreveshje, përfshirë por pa u kufizuar çdo debat lidhur me vlefshmërinë, hartimin, zbatimin, interpretimin, mosrespektimin ose zgjidhjen e kësaj Marreveshje, të cilat nuk janë zgjidhur në mënyrë miqësore brenda afatit të parashikuar në Nenin 19.1 më lart, do të zgjidhen në mënyrë ekskluzive dhe përfundimisht nga Gjykata Kompetente Shqiptare.

19.3.2 Vendi i gjykimit do të jetë Fier.

19.3.3 Vendimi i formes se prere i Gjykates do të jetë i detyrueshëm për Palët.

Neni 20
Mbrojtja e Mjedisit

20.1. Pa cënuar Nenin 4.1 Kontraktori përgjatë kryerjes së Operacioneve, nuk do të prekë sipërfaqen e Zonës së Mbrojtur Mjedisore dhe Zonës me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, por do të veprojë dhe do të zbatojë të gjithë legjislacionin Shqiptar në fuqi në fushën e Mjedisit dhe Turizmit, përfshirë por pa u kufizuar legjislacionin, vendimet, rregulloret e KKT-së/Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, apo çdo akti tjetër ligjor/nënligjor nga Organe të tjera Kompetente, në lidhje me Zonat e Mbrojtura dhe Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, ose ndonjë ndryshim në interpretimin ose zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese për mjedisin dhe turizmin, që do të miratohen pas Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshje.

20.2 Kontraktori do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për të zbatuar programet e pranuara, në mënyrë për të eliminuar ose minimizuar ndotjen mjedisore. Në rastet kur Kontraktori nuk ka pasur mundësi të shmangë ndotjen e mjedisit, ai do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e arsyeshme për ta kthyer mjedisin e prekur, sa më shumë të jetë e mundur, në gjendjen e tij fillestare në Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marreveshje, si dhe të ndreqë ndikimin e ndjeshëm negativ që kanë shkaktuar drejtpërdrejt në mjedis Operacionet e Hidrokarbureve, sipas kërkesave dhe dispozitave të legjislacionit shqiptar dhe rregulloreve që janë në fuqi për industrinë e naftës dhe të gazit natyror, si dhe në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare për Industrinë e Naftës dhe Gazit.

Neni 21
Mallrat dhe Shërbimet

21.1 Kontraktori, kontraktoret dhe nen-kontraktoret e tij do ti japin prioritet mallrave dhe materialeve te prodhuara ne Shqiperi, nese keto mallra dhe materiale ofrohen sipas kushteve favorizuese te barabarta ne lidhje me cilesine, cmimin dhe disponueshmerine, dhe ne sasite e kerkuara. Kontraktori do ti jape prioritet sherbimeve te kryera nga nen-kontraktore Shqiptare nese keto sherbime sipas kushteve favorizuese jane te njejta ne lidhje me cilesine, cmimin dhe disponueshmerine qe ato mund te ofrohen nga nen-kontraktore te huaj.

Per qellimet e mesiperme, cmimet per materialet, paisjet, makinerite dhe gjerat e konsumueshme te prodhuara brenda vendit dhe per sherbimet e kontraktoreve lokal duhet te jene te krahasueshem me cmimet e mallrave dhe sherbimeve ne tregun nderkombetar pasi te jene shtuar kostot per transport dhe siguracion.

21.2 Kontraktori do te beje tendera konkurues per ndonje sherbim te kryer ne perputhje me ceshtjet e perfshira ne nje Program Vjetor dhe Buxhet, nese sherbime te tilla priten te kalojne vleren prej një milion $US (1,000,000.00 $US). Albpetroli rezervon te drejten te ndjeke hapjen e ofertave per te gjithe tenderat e tille, ne statusin e vezhguesit.

Neni 22
Konfidencialiteti

22.1 Përvec sa specifikohet ndryshe sipas kësaj Marrëveshje, gjithë informacioni i kryer, i përfituar ose marë sipas kësaj Marreveshje do te mbahet nga Palet konfidencial në mënyre strikte dhe nuk do të bëhet i ditur pa aprovim paraprak me shkrim të Palës tjeter për sa kohe që kjo Marrëveshje mbetet ne fuqi, pervec se në masën e kërkuar për të vepruar ne perputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret të cdo burse për te cilen Kontraktori mund te jete subjekt po qe se ky informacion nuk behet pjese e sferes publike nepermjet burimesh pervec se Kontraktorit. Per me teper, Kontraktori do te jete i lidhur me këto detyrime konfidencialiteti per nje periudhe prej pese (5) vjet ne vijim te perfundimit te kesaj Marreveshje.

22.2 Albpetroli dhe Kontraktori mund ta ekspozojne kete informacion konfidencial tek punonjesit e vet, Filialet, konsulentet ose nen-kontraktoret, ne masen e kerkuar per kryerjen efiçente te Operacioneve Hidrokarbure me kusht qe, ne rastin e ekspozimit tek punonjesit dhe Filialet te sigurojne mbrojtje te mjaftueshme te natyres se konfidencialitetit te informacionit ne fjale, dhe ne rastin e ekspozimit tek konsulentet ose nen-kontraktoret me kusht qe marresit e synuar te kene hyre fillimisht ne nje marreveshje konfidencialiteti.

22.3 Per qellime te marrjes se ofertave te reja ne pjese te Zones se Marrreveshjes nga te cilat eshte hequr dore ose ne zona prane Zones se Marreveshjes, Albpetroli mund ti tregoje te dhena ndonje entiteti tjeter mbi pjese te tilla qe eshte hequr dore, ne nje forme baze te panderprere gjate kohezgjatjes se kesaj Marreveshje.

22.4 Ne perputhje me marrjen e marreveshjeve te konfidencialitetit sic jepet ne Nenin 23.2 me siper, cilado Pale mund ta ekspozoje kete informacion te marre ne perputhje me kete Marreveshje, sic mund te kerkohet nga institucione financiare, nga te cilet Pala qe ekspozon eshte duke kerkuar financim per qellime te zbatimit te detyrimeve te tij te parashikuara ne kete Marreveshje ketu.

22.5 Në përputhje me një marrëveshje konfidencialiteti, Kontraktori mund të tregojë ndonje informacion të tille ne mirëbesim (*bona fide*) marresve potenciale te interesave, te cilet jane te interesuar në të drejtat e hidrokarbureve qe i janë dhëne Kontraktorit sipas kesaj Marreveshje.

Neni 23
Abandonimi (Dekomisionimi)

23.1. Në mënyre që Kontraktori të rekuperoje kostot që lidhen me Dekomisionimin e Vendburimit ne te ardhmen, rikthimin ne gjendjen e meparshme (gjendjen para Dates Efektive) dhe çdo shpenzim tjetër të ngjashëm që duhet të përballohet nga Kontraktori sipas Marreveshjes Hidrokarbure, Kontraktori ka të drejtë të krijojë një fond rezervë për dekomisionimin e ardhshëm dhe rikthimin ne gjendjen e meparshme (një "Fond Rezervë Dekomisionimi"). Fondi Rezervë për Dekomisionimin mund të krijohet në çdo kohë gjatë 10 (dhjete) Viteve Kalendarike te fundit të afatit të Operacioneve Prodhuese të Vendburimit, por me kërkesë të arsyeshme nga Kontraktori, autoritetet shqiptare do të lejojnë Kontraktorin të krijojë fondin përgjate një periudhë më të gjatë. Pas krijimit te ketij fondi, Kontraktori do të derdhë kontribute në mënyrë të rregullt në Fondin Rezervë të Dekomisionimit bazuar në kostot e vlerësuara te dekomisionimit dhe rikthimit ne

gjendjen e meparshme në përputhje me parimet standarde dhe normat teknike të pranuara përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të naftës dhe gazit natyror dhe duke marrë parasysh interesin e marrë dhe interesin e ardhshëm që do të fitohet në Fondin Rezervë te Dekomisionimit. Çdo kontribut nga ana e Kontraktorit në Fondin Rezervë të Dekomisionimit do të konsiderohet Kosto Hidrokarbure kur të paguhet në fondin rezervë që do të rekuperohet nga Kontraktori. Te gjitha shpenzimet e kryera per mirembajtjen e ketij fondi, do te njihen si kosto hidrokarbure. Kontributet në Fondin Rezervë të Dekomisionimit do të vendosen ne një bankë të miratuar nga Komiteti Këshillimor.

23.2. Nëse, në fund të afatit të Operacioneve Prodhuese të Vendburimit, autoritetet shqiptare vendosin të marrin përsipër operacionet e prodhimit në Vendburim:

- autoritetet shqiptare do të bëhen përgjegjëse për dekomisionimin e saj të ardhshëm dhe rikthimin ne gjendjen e meparshme;

- kontributet dhe çdo interes i akumuluar në Fondin e Rezervës për Dekomisionimin, deri në masën që këto kontribute janë rikuperuar si Kosto Hidrokarbure, do t'u paguhen autoriteteve shqiptare; dhe

- autoritetet shqiptare do të lirojnë Kontraktorin nga çdo detyrim që ka të bëjë me dekomisionimin dhe rikthimin ne gjendjen e meparshme dhe duhet të dëmshpërblejnë Kontraktorin për çdo kosto, detyrim, shpenzim, kërkesa ose detyrime që lidhen me to.

23.3 Nëse Kontraktori merr përsipër punimet per Dekomisionimin dhe rikthimin ne gjendjen e meparshme, kontributet dhe çdo interes i akumuluar në Fondin e Rezervës së Mbylljes do t'i paguhen Kontraktorit dhe do të përdoren për Operacionet e Dekomisionimit. Kontraktori do të ndërmarrë çdo operacion të tillë për Dekomisionimin në përputhje me praktikën standarde në industrinë ndërkombëtare të naftës dhe gazit.

23.4 Nëse Fondi Rezervë për Dekomisionimin nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha Kostot e Dekomisionimit për Vendburimin, bilanci do të paguhet nga Kontraktori.

23.5 Nëse Fondi Rezervë për Dekomisionimin tejkalon të gjitha kostot për Dekomisionimin e Vendburimit, bilanci do të transferohet tek autoritetet shqiptare nese diferenca eshte rikuperuar si kosto hidrokarbure, ne te kundert i kthehet Kontraktorit.

23.6 Çdo shpenzim i kryer nga Kontraktori në lidhje me këtë Nen, duke përfshirë, por pa u kufizuar në çdo kontribut në Fondin Rezervës për Dekomisionimin, do të konsiderohet Kosto Hidrokarbure dhe do të rekuperohet nga Kontraktori.

23.7 Kontraktori do t'i dorëzojë Komitetit Këshillimor për miratim një plan të detajuar për dekomisionimin të objekteve të Zonës Prodhuese dhe restaurimit të lokacionit ("Plani i Dekomisionimit"), një Plan i tillë Dekomisionimi do të dorëzohet jo më vonë se 24 (njëzet e katër) muaj para datës së vlerësuar nga ana e Kontraktorit për përfundimin e Prodhimit Komercial nga Zona e Prodhimit.

23.8 Me aprovim te AKBN-se, gjitha paisjet dhe mjetet (duke përfshirë puset) e përdorura ekskluzivisht ne Operacionet Hidrokarbure do të abandonohen ne përputhje me praktikat përgjithësisht të pranuara të industrisë ndërkombëtare të naftës. Ky aprovim duhet te jepet nga AKBN brenda nje afati prej 30 ditesh, ne rast te kundert konsiderohet e miratuar ne heshtje. Sidoqofte, asgjë që përmbahet në këtë Marrëveshje nuk do të detyroje Kontraktorin të Abandonoje paisjet dhe mjetet e paperdorura në Operacionet Hidrokarbure, dhe Albpetroli, AKBN-ja dhe Ministria do te mbrojne, cdemtojne dhe mbajne Kontraktorin të pa cënuar kundrejt kostove dhe pretendimeve bazuar ne detyrime te tilla.

Neni 24
Zgjidhja

24.1 Kjo Marreveshje mund te perfundohet nga Kontraktori duke njoftuar paraprakisht Albpetrolin me nje njoftim me shkrim jo me pak se tridhjete (30) dite, me kusht qe kjo zgjidhje nuk do ta cliroje Kontraktorin nga ndonje angazhim i paplotesuar ose detyrim tjeter sipas kesaj Marreveshje i lindur para ketij perfundimi.

24.2 Kjo Marreveshje mund te perfundohet nga Albpetroli duke njoftuar paraprakisht Kontraktorin me nje njoftim me shkrim jo me pak se nentedhjet (90) dite dhe ne rastet e meposhtme:

24.2.1 Nese Kontraktori ne menyre te perseritur ka kryer nje shkelje materiale te detyrave dhe detyrimeve te tij themelore sipas kesaj Marreveshje dhe eshte informuar nga Albpetroli per synimin e Albpetrol-it per perfundimin e kesaj Marreveshje. Ky njoftim per perfundimin e kesaj Marreveshje nga Albpetroli do ti jepet Kontraktorit vetem pas marrjes se njoftimit nga Albpetroli qe ky i fundit eshte ne shkelje materiale dhe nuk korrigjon ne menyre substanciale kete shkelje brenda nentedhjete (90) ditesh nga njoftimi i kryer; ose

24.2.2 Nëse Kontraktori thelbesisht nuk vepron në perputhje me ndonje vendim te formes se prere që rezulton nga një procedure gjykate në përputhje me Nenin 19 këtu; ose

24.2.3 Nese Kontraktori gjykohet i falimentuar nga nje gjykate kompetente, ose ka me shume se nje entitet qe perbejne Kontraktorin, dhe ndonje prej tyre deklarohet i falimentuar pa entitetet e tjere ose entiteti merr veprimin e duhur te rregulloje situaten ne lidhje me kete Marreveshje.

24.2.4 Nese Kontraktori depoziton tek Albpetroli dhe AKBN-ja te dhena të falsifikuara financiare, teknike apo administrative.

24.3 Marreveshja do të zgjidhet me efekt të menjëhershëm në rastet e mëposhtme:

a) Kontraktori nuk merr të gjitha hapat e nevojshëm për të nisur zbatimin e Programin te Vlerësimit brenda tre (3) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kesaj Marreveshje e përcaktuar në Nenin 4.1 dhe Nenin 6.1 te saj.

b) Kontraktori nuk depoziton ne AKBN garancine bankare sipas formatit te percaktuar ne Aneksin E te kësaj Marreveshje. Me kalimin e afateve te parashkuar ne piken 24.3 dhe Neni 26.6 Albpetrol do te dergoje nje shkrese tek Kontraktori ku e njofton per zgjidhjen e menjëhershme të kësaj Marreveshje dhe zgjidhja e Marreveshjes e berë në ketë mënyre do të jetë efektive dhe e vlefshme.

24.4 Ne rast te zgjidhjes perfundimtare te kesaj Marreveshje, te gjitha puset, operacionet, asetet (Te levizshme apo te palevizshme) do te kthehen tek AKBN, ne gjendje optimale si dhe te dokumentohet momenti i kthimit te ketyre aseteve.

Neni 25
Auditet

25.1 Albpetroli do të ketë një periudhe prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga marrja e secilës deklarate, të Llogarisë Kostot në përputhje me Proçeduren Llogaritëse për te audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonje deklarate të tille te Llogarise Kostot, me kusht qe Albpetroli nuk do te titullohet te kryeje me shume se dy audite te librave te llogarise, regjistrimeve dhe llogarive ne nje Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do te bien dakort per cdo rregullim te kerkuar. Dokumenta shtese dhe llogarie do te behen te disponueshme per Albpetrolin gjate periudhes dymbedhjete (12) mujore ne fjale. Nese brenda kohes kufi te periudhes tre (3) mujore ne vijim te kalimit te periudhes se mesiperme prej dymbedhjete (12) muajsh, Albpetroli nuk ka keshilluar Kontraktorin me kundershtimin e tij per kete deklarate, kjo deklarate do te konsiderohet e aprovuar.

Neni 26
Klauzola te Pergjithshme

26.1 Njoftimet

26.1.1 Njoftimet dhe komunikimet e tjera te kerkuara ose te lejuara per tu dhene sipas kesaj Marreveshje do te gjykohen te dhena kur jane derguar dhe marre me shkrim, ose me dore ose nepermjet postes ose adreses elektronike (e-mail) ne adresat e duhura si me poshte:

per **Albpetrolin**:

Albpetrol Sh. A.
Lagja 29 Marsi
Patos, Albania
Per dijeni: Administratori

E mail:arkiva@albpetrol.al

per **Kontraktorin**:

Edg Natural Gas SHPK
Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Tirane
Per dijeni: Administratori Z. Erald Bakiu

Email: erald.bakiu@edgenergy.al

Albpetroli dhe Kontraktori mund te ndryshojne adresen ose adresat e tyre duke njoftuar me shkrim njeri-tjetrin per kete ndryshim paraprakisht ose menjëherë pas ndryshimit. Mosnjoftimi si me lart, ngarkon palën përkatëse për pergjegjësi dhe detyrim per te dëmshpërblyer (sipas rastit) palën tjeter per cdo dem qe mund t'i jete shkaktuar.

26.1.2 Njoftimet e dhena nga Albpetroli tek Kontraktori do te gjykohen te dhena nese jepen ne zyren qëndrore te Kontraktorit sipas pikes 26.1.1 te ketij Neni.

26.2 Pergjegjesia

26.2.1 Kontraktori duhet te mbaje përgjegjësi per te gjitha rastet e përgjegjesisë sikunder parashikohet ne legjislacionin shqipatar te zbatueshëm.

26.2.2 Ne rast te ndonje demtimi per te cilen Kontraktori behet pergjegjes ne perputhje me Nenin 26.2.1, Kontraktori do te perpiqet qe ne menyre te menjehershme dhe te zellshme te marre masat e nevojshme, ne perputhje me legjislacionin shqiptar te zbatueshem si dhe me praktikat nderkombetare te industrise se naftes dhe gazit, te zbuse demin dhe te rivendose normalitetin e Operacioneve Hidrokarbure. Kontraktori do te paguaje demshperblim kompensues per ate per te cilen ai eshte deklaruar perfundimisht përgjegjës nga gjykata, te cilat nuk do te konsiderohen si kosto te rikuperueshme.

26.2.3 Kontraktori eshte i detyruar të dëmshpërbleje plotësisht të gjithë institucionet shtetërore të përfshira, duke marrë mbi vete çdo lloj përgjegjësie me faj humbje, dëmtim, duke përfshirë por pa u kufizuar, dëmtime në mjedis dhe shpenzime të tjera të arsyeshme profesionale, të shkaktuar nga: (i) shkelja materiale e dispozitave të Marreveshjes nga Kontraktori dhe personeli i tij duke përfshirë atë të nënkontraktorëve apo pasuesve të tij; dhe (ii) çdo dhe të gjithë aktet e neglizhencës, dhe mospërmbushja e detyrimeve kontraktore nga Kontraktori dhe personeli i tij duke përfshirë atë të nënkontraktorëve apo pasuesve të tij. Ky dëmshpërblim do të jetë i kërkueshëm edhe pas zgjidhjes së kesaj Marreveshje.

26.3 Gjuha e Tekstit

Kjo Marrëveshje është hartuar dhe nenshkruar ne 4 (kater) kopje origjinale, me vlere te njejte ligjore, ne gjuhen shqipe.

26.4 Efektiviteti

Kjo Marrëveshje hyn ne fuqi dhe është ligjore dhe detyruese që prej Dates Efektive.

26.5 E Gjithe Marrëveshja

Kjo Marreveshje (se bashku me cdo dokument te referuar brenda ne te) perben gjithe Marreveshjen ndermjet Paleve dhe zevendeson cdo marreveshje te mepareshme, mirekuptim, rregullim, riperfaqesim, marrje persiper dhe garanci ndermjet Paleve ne lidhje me objektin e kesaj Marreveshje, duke perfshire pa kufizim termat e tenderimit per Zonen e Marreveshjes dorezuar Albpetrolit.

26.6 Garancia Bankare

Kontraktori do t'i paraqes AKBN-se brenda gjashtedhjete (60) diteve nga Data Efektive, nje Garanci Bankare per angazhimin financiar te Programit te Punes per Periudhen perkatese te Vleresimit.

26.7 Anekset

Anekset A, B, C, D, E, F dhe G behen ketu nje pjese integrale dhe e pandare e kësaj Marrëveshje dhe do të konsiderohen sikur kane të njëjtën fuqi ligjore dhe efekt me klauzolat e pjeses kryesore te kesaj Marreveshje. Sidoqofte, ne rast te ndonje konflikti ndërmjet pjeses kryesore te kesaj Marreveshje dhe ndonje Aneksi, klauzolat e pjeses kryesore do te mbizoterojne.

26.8 Ndryshime

Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marreveshje janë të vlefshme vetëm në rast se bëhen me shkrim, nënshkruhen nga Palet dhe miratohen nga Autoritetet Kompetente shqiptare.

26.9 Autoriteti

Secila pale, e cila eshte nje nenshkruese ne kete Marreveshje garanton tjetrin qe ai ka fuqi dhe autoritet te plote per te hyre ne kete Marreveshje dhe qe kjo Marreveshje perben nje detyrim ligjor, te vlefshem dhe detyrues ndaj saj.

ME DESHMI KETU, Palet hyjne ne kete Marreveshje ne daten e shkruar me siper.

Albpetrol Sh.A.

Nga : KLEJDI CENMURATI

Titulli : ADMINISTRATOR

30.05.2022

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISË ALBPETROL Sh.a. ADMINISTRATORI MINIM-PATOS

EDG Natural Gas Sh.P.K

Nga: ERALD BAHIU DT. 30.05.2022

Titulli: ADMINISTRATOR

EDG NATURAL GAS SH.P.K. NIPT: M117070291 TIRANE - ALBANIA

ANEKSI A
PËRSHKRIMI I ZONËS SË MARREVESHJES

Zona e Marreveshjes, që mbulohet dhe preket nga kjo Marreveshje përfshin, në Datën e Hyrjes në Fuqi, zonën e rrethuar nga bashkimi i pikave P1, P2, P3, P4 dhe P5, të paraqitur edhe në hartën që përbën Aneksin B.

KORDINATAT GJEODEZIKE TE VENDBURIMIT TE GAZIT NATYROR POVELÇE

Vendburimi POVELÇË

Nr.	Gjatësia gjeografike (grad, min, sek)	Gjerësia gjeografike (grad, min, sek)
P1	40° 40' 22.135" N	19° 22' 04.396" E
P2	40° 41' 39.906" N	19° 22' 02.499" E
P3	40° 44' 22.590" N	19° 22' 45.401" E
P4	40° 44' 23.067" N	19° 23' 19.484" E
P5	40° 40' 03.827" N	19° 23' 25.729" E

Vendburimi i Povelces deri ne thellesine 3000m, Pliocen – Torton, perfshire.

ANEKSI B
HARTA E ZONËS SË KONTRATËS: VENDBURIMI POVELÇE



ANEKSI C
PROCEDURA KONTABËL

Neni I. Dispozita te Pergjithshme

I bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Marreveshje midis Palëve Procedura Kontabel perfshire por pa u kufizuar ne perputhje sipas parashikimeve te Ligjit Nr.153/2020 "Per regjimin fiskal ne Sektorin Hidrokarbur" si dhe se bashku me parashikimet e meposhtme.

Kur në këtë Procedurë Kontabël ka referime për Kontraktorin që lidhen me një të drejtë apo detyrim që lind nga kryerja e Operacioneve Hidrokarbure (duke përfshirë pa kufizim në lidhje me ndonjë regjistër kontabël, pasqyrë, kosto apo auditim), këto referime do t'i atribuohen edhe Operatorit si subjekti përgjegjës për kryerjen, për llogari të Kontraktorit, e të gjitha Operacioneve Hidrokarbure sipas Marreveshjes.

1. Regjistrat Kontabël

1.1 Kontraktori do të mbajë regjistrat kontabël në përputhje, me Ligjin nr.25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi.

1.2 Kontraktori do të hartojë dhe mbajë më vete regjistra kontabël të identifikueshëm që mund të jenë të nevojshëm për të regjistruar plotësisht dhe në mënyrën e duhur të gjitha kostot që lidhen me Marreveshjen dhe të gjitha kreditimet e marra nga Kontraktori në lidhje me Operacionet Hidrokarbure.

1.3 Librat kontabël do të mbahen në monedhen shqiptare Lek, në përputhje me Nenin 15.2 të Marreveshjes. Çdo humbje apo fitim që rezulton nga këmbimi i monedhës së kërkuar për Operacionet Hidrokarbure të Kontraktorit ose nga konvertimet përkatëse nga një monedhë në tjetrën do t'i ngarkohet apo kreditohet Kostove të Mbulueshme.

1.4 Me qëllim përcaktimin e koeficientit "R", Kontraktori do të mbajë një sistem llogarish për regjistrimin, në monedhen shqiptare Lek, të të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhen me Operacionet Hidrokarbure të përcaktuara në Nenin 9. Ky sistem duhet të përbëhet nga dy llogari kryesore: Llogari të ardhurash të koeficientit "R" dhe llogari shpenzimesh të koeficientit "R".

2. Situacioni i veprimtarive

2.1 Kontraktori do ti dorëzojë Albpetrol-it dhe AKBN-s, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga përfundimi i çdo Tremujori Kalendarik, një Situacion të Veprimtarisë së Zhvillimit sipas Nenit 7 të Marreveshjes, ku pasqyrohen të gjitha detyrimet dhe kreditimet në lidhje me Zhvillimin dhe Prodhimin për atë Tremujor Kalendarik (**"Shpenzimet e Zhvillimit dhe Shpenzimet Operative"**), që të përfshijë totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit, të përmbledhura sipas klasifikimeve të duhura që tregojnë natyrën e tyre.

3. **Auditimet dhe rregullimet**

3.1 Çdo zë i kostove në një Situacion të Veprimtarisë së Vlerësimit dhe Zhvillimit do të konsiderohet përfundimisht si Kosto e Miratuar pas dymbëdhjetë (12) Muajsh nga data që Albpetrol merr Situacionin nga ana e Kontraktorit, përveç rastit kur Albpetroli e kundërshton atë me shkrim në bazë të kontrollit/auditimit brenda periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë, në përputhje me Nenin 25 të Marreveshjes. Në këtë rast, Albpetroli dhe Kontraktori do të bisedojnë në kohë dhe do të përpiqen që të arrijnë një zgjidhje, kohë gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë Kostot e Refuzuara dhe Kostot e Pezulluara që rezultojnë nga ky auditim.

3.2 Çdo zë i kostove në një Situacion të Veprimtarisë së Zhvillimit do të konsiderohet përfundimisht si Kosto e Miratuar pas tridhjetë e gjashtë (36) muajsh nga data që AKBN merr Situacionin. Nëse AKBN nuk e kundërshton atë me shkrim në bazë të kontrollit/auditimit brenda Periudhës në fjalë tridhjetë e gjashtë (36) mujore, me përjashtim të dyzetë e tetë (48) muajve të parë të Periudhës së Zhvillimit dhe Prodhimit, ku çdo zë i kostove në Situacionin e Veprimtarisë së Zhvillimit do të konsiderohet përfundimisht si Kosto e Miratuar pas dymbëdhjetë (12) muajve nga data e marrjes së atij Situacioni nga AKBN, nëse kjo e fundit nuk e kundërshton atë me shkrim në bazë të kontrollit/auditimit brenda po kësaj periudhe dymbëdhjetë (12) mujore. Në rast se AKBN-ja bën kundërshtime të tilla me shkrim, AKBN-ja dhe Kontraktori do të hyjne ne bisedime ne kohe per te arritur nje zgjidhje, periudhë gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë Kostot e Refuzuara dhe Kostot e Pezulluara që rezultojnë nga auditimi në fjalë dhe nëse nuk zgjidhet, zëri apo zërat objekt i mosmarrëveshjes do të zgjidhen siç parashikohet në Nenin 19 të kesaj Marreveshje.

4. **Interesi për pagesën me vonesë**

Nëse një Palë nuk arrin të kryejë ndonjë pagesë, që rrjedh nga dispozitat e kësaj Marreveshje, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e asaj pagese, atëherë kjo Palë, përveç pagesës së prapambetur, do të paguajë edhe interes me normë ne bazw te Ligjit Nr. 48/2014, "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore dhe tregtare" *i ndryshuar*.

Neni II. Kostot Hidrokarbure

Sipas dispozitave të Marreveshjes, Kontraktori do të mbulojë i vetëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes Filialeve të Kompanisë, do të paguajë kostot dhe shpenzimet e mëposhtme, të cilat do të trajtohen dhe mbulohen nga Kontraktori në përputhje me parashikimet e Marreveshjes, me kusht që ato të mos jenë kryer përpara Datës së Hyrjes në Fuqi.

Kostot dhe shpenzimet e mëposhtme do të jenë të Mbulueshme:

1. **Pagesat për Qeverinë**

Të gjitha tarifat shtetërore, tarifat e qirasë, vlerësimeve, rinovimeve dhe zgjatjes dhe çdo pagesë tjetër e çfarëdo lloji dhe natyre e paguar nga Kontraktori sipas kushteve të Marreveshjes, përveç bonuseve të paguara sipas Nenit 10 të Marreveshjes.

2. Kostot e personelit dhe kostot e lidhura me të

Kostot aktuale te te gjithe punonjesve te Kontrakorit dhe kostot e personelit te emeruar, ose perkohesisht te emeruar ose te kontraktuar nga Kontraktori, por pa u kufizuar ne:

1.1 Pagat bruto, pagesat orare si dhe shperblimet mbi to, te të gjithë punonjësve të përfshirë në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë. Nëse këta punonjës përfshihen edhe në veprimtari të ndryshme nga Operacionet Hidrokarbure, kostoja e tyre do të shpërndahet në bazë të pasqyrave të orëve të punës, në përputhje me parimet kontabël të njohura e të pranuara.

1.2 Kostoja per ore shtese, festa, pushime, perfitimet ne rast semundje, perftime per paaftesi dhe leje te tjera te aplikueshme ndaj pagave te pagueshme sipas pikes 2.1.

1.3 Shpenzime, tatime dhe pagesa te tjera, nese ka ndonje, te bera ne perputhje me vleresimet dhe detyrimet tatimore nga autoritet tatimore sipas legjislacionit ne fuqi, te aplikueshme ndaj kostos se pagave te pagueshme sipas pikes 2.1

1.4 Shpenzimet ose kontributet e bëra sipas vlerësimeve apo detyrimeve të parashikuara në ligjet e Republikës së Shqipërisë, që zbatohen për kostot e Kontraktorit në lidhje me pagat, siç parashikohet në paragrafin 2.3.

2.5 Koston e skemave per sigurimin e jetes se punonjesve, trajtimin e tyre spitalor, pensionet, skemat e kursimeve dhe perfitimeve te tjera te se njejtes natyre, te aplikueshme ndaj pagave te pagueshme sipas pikes 2.1.

2.6 Kostot e transportit te te gjithe punonjesve, te familjeve te ketyre punonjesve (e kufizuar tek gruaja dhe femijet ne ngarkim), si dhe te sendeve personale të tyre, ne dhe nga vendi i origjines, e percaktuar ne kontraten e punes.

2.7 Kostot e Kontraktorit për planet e sigurimit të jetës në grup të punonjësve që u ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure sipas paragrafit 2.

2.8 Kostot e akomodimit te te gjithe punonjësve të përfshirë në kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë dhe dietat ushqimore te percaktuara sipas legjislacionit ne fuqi.

2.9 Shpenzimet e arsyeshme personale të personelit, pagat e të cilëve u ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure sipas pikes 2.1 dhe për të cilat shpenzimet e personelit rimbursohen sipas politikave standarde të Kontraktorit për personelin. Në rast se këto shpenzime nuk i atribuohen plotësisht Operacioneve Hidrokarbure, këtyre operacioneve do t'u ngarkohet vetëm pjesa e zbatueshme e tyre, e cila do të përcaktohet mbi baza proporcionale.

2.10 Kostot e kualifikimit per punonjesit e Kontraktorit, ose te personelit te emeruar, ose perkohesisht te emeruar ose te kontraktuar nga Kontraktori.

3. Materialet

Materialet, pajisjet dhe furnizimet e blera apo të furnizuara nga Kontraktori për përdorim në Operacionet Hidrokarbure, në përputhje me Marreveshjen, Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe sipas rastit, politikat, standardin dhe praktikat e prokurimit dhe kontraktimit të Operatorit.

3.1 Blerja

Materialet dhe paisjet e blera do të ngarkohen ne koston neto aktuale te kryer nga Kontraktori sipas fatures se cmimit te shitesit, paketimit, transportimit, shpenzimeve te ngarkimit dhe shkarkimit, kostot e sigurimit, taksat doganore, pagesave dhe taksat e aplikueshme, nese ka ndonje, duke zbritur te gjitha uljet e marra aktualisht. Çmimi përfshin, por pa u kufizuar në, tarifat e inspektimit dhe shpërndarjes, tarifat e ndërmjetësve të eksportit, tarifat e transportit te brendshem dhe nderkombetar, pagesat e sigurimeve, tarifat e ngarkim-shkarkimit, detyrimet e importit dhe tarifat e licencave, si dhe të gjithë zërat e tjerë që zakonisht shoqërohen me prokurimin e materialeve dhe pajisjeve dhe tatimet e zbatueshme.

3.2 Materialet e furnizuara nga Kontraktori

Materialet e nevojshme për Operacionet Hidrokarbure do të blihen drejtpërdrejt, sa herë që kjo të jetë e mundur, përveç rastit kur Kontraktori mund t'i importojë ato nga stoku jashtë Shqipërisë i Kontraktori apo i Filialeve të Kompanisë së Kontraktorit, sipas kushteve të mëposhtme:

3.2.1 Materialet e reja (kategoria "A")

Materialet e reja të transferuara nga magazinat apo pronat e tjera të Filialeve të Kompanisë së Kontraktorit do të vlerësohen si kosto hidrokarbure, minus çdo skonto, me kusht që kostoja e furnizimeve të materialeve të mos jetë më e lartë se çmimet ndërkombëtare për materiale me cilësi të ngjashme, të furnizuara me kushte të ngjashme që janë mbizotëruese në kohën që janë porositur këto materiale.

3.2.2 Materialet e përdorura (Kategoritë "B" dhe "C") që do të përdoren me miratimin e Albpetrol-it dhe AKBN-së. Kete miratim AKBN duhet ta jap brenda 30 diteve, ne rast te kundert kerkesa konsiderohet e miratuar ne heshtje.

3.2.2.1 Materialet që janë në gjendje të mirë dhe funksionale për t'u ripërdorur pa u riparuar do të klasifikohen si materiale të kategorisë "B" dhe do të çmohen me shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të çmimit të materialit të ri. Kjo kategori përfshin, por nuk kufizohet në, materialet që i janë nënshtruar një procesi riparimi dhe janë restauruar në gjendje të plotë Pune.

3.2.2.2 Materialet që nuk mund të klasifikohen si materiale të kategorisë "B", por që janë në gjendje Pune për funksionin e tyre fillestar, por jo mjaft të përshtatshme për riparim, do të klasifikohen si materiale

të kategorisë "C" dhe çmohen me pesëdhjetë për qind (50%) të çmimit të materialeve të reja.

3.2.2.3 Materialet që nuk mund të klasifikohen si materiale të kategorisë "B" ose "C" do të çmohen me një vlerë proporcionale me përdorimin e tyre.

3.3 Çmimet premium

Kurdoherë që materiali nuk mund të sigurohet në pikat e zakonshme të furnizimit dhe me çmimet e specifikuara në Nenet 3.1 dhe 3.2 të këtij paragrafi 3, për shkak të emergjencave kombëtare, grevave apo për shkaqe të tjera të pazakonta, Kontraktori mund ta faturojë materialin e kërkuar në bazë të kostove e shpenzimeve direkte të kryera nga Kontraktori për prokurimin e këtij materiali, për ta bërë atë të përshtatshëm për përdorim dhe për dërgimin e tij në vendndodhje.

3.4 Garancia e materialeve të blera apo të furnizuara nga Kontraktori

Kontraktori nuk jep garanci për materialin. Garancia e vetme për materialin e blerë apo të furnizuar nga Kontraktori është garancia e shitësit apo prodhuesit; në rast se materiali rezulton me defekte, kreditimi/vlera do të transferohet siç merret nga ose në përputhje me garancinë e furnizuesit apo prodhuesit, kur rregullimi për Kontraktorin është bërë nga furnizuesi apo prodhuesi.

4. Transporti

Kostot e transportit të punonjësve, paisjeve, materialeve dhe furnizimeve të ndryshme nga ato të parashikuara në Nenin 2 të kësaj Procedure Kontabël, që janë të nevojshme për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure sipas Marreveshjes, si dhe kostot e tjera në lidhje me to, duke përfshirë por pa u kufizuar ne detyrimet sipas legjislacionit shqiptar te zbatueshme ne fuqi apo tarifat e shkarkimit, tarifat e dokut dhe shpenzimet e transportit tokësor dhe detar.

5. Shërbimet dhe mallrat nga Palë të treta

Kostoja e konsulentëve, shërbimeve të kontraktuara dhe mallrave që Kontraktori i prokuron nga palët e treta për t'i përdorur në Operacionet Hidrokarbure, në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe sipas rastit, me rregulloret, standardet dhe praktikat e prokurimit dhe kontraktimit të Operatorit.

6. Shpenzimet administrative dhe kostot e Filialeve

6.1 Shërbimet teknike dhe profesionale

Shërbimet e ofruara nga Kontraktori apo Filialet e tij do të kryhen sipas një Urdhri Pune apo Kontrate shërbimi të lëshuar nga Operatori. Këto shërbime do të kërkohen nga Operatori dhe do t'i ngarkohen Operacioneve Hidrokarbure në bazë të tarifave, në bazë të çdo tarife tjetër të bazuar në metodën e alokimit, në përputhje me Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe me udhëzimet për transferimin e çmimit për ndërmarrjet shumëkombëshe, të nxjerra nga Organizata për

Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe të garantuara në mënyrë të pavarur nga një firmë e njohur kontabiliteti.

7. Dëmet dhe humbjet

Të gjitha kostot dhe shpenzimet e nevojshme për rikuperimin apo korrigjimin e dëmeve ose humbjeve të shkaktuara nga zjarri, përmbytjet, vjedhja vetem ne rastin kur ajo ka ndodhur pavaresisht nga te gjitha masat e pershtatshme dhe te nevojshme te marra nga ana e Kontraktorit per parandalimin e saj, aksidentet apo çdo shkak tjetër që është jashtë kontrollit të Kontraktorit. Për te gjitha dëmet apo humbjet, Kontraktori do t'i dorëzojë AKBN-së dhe Albpetrol-it një njoftim me shkrim për dëmet ose humbjet e ndodhura sa më shpejt që të mundet pas marrjes së raportit për to nga Kontraktori.

8. Shpenzimet ligjore

Të gjitha kostot apo shpenzimet e shqyrtimit, hetimit, konfirmimit, mbrojtjes dhe zgjidhjes së çdo pretendimi apo veprimi ligjor të nevojshëm për marrjen, ruajtjen dhe mbrojtjen e zonës së Kontratës dhe për mbrojtjen apo ndjekjen penale të padive që përfshijnë zonën e Kontratës apo të çdo pretendimi që lind nga Operacionet Hidrokarbure ose shumat e paguara për shërbimet ligjore të nevojshme për mbrojtjen e interesave të përbashkëta të AKBN-së, Albpetrol-it dhe Kontraktorit (përveç kostove dhe shpenzimeve për pretendimet, veprimet ligjore, kërkesë paditë apo mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve, si dhe kostot për cdo gjykim kundrejt Kontraktorit që nuk ka lidhje me Marreveshjen dhe operacionet hidrokarbure).

9. Tatimet

Të gjitha taksat, detyrimet apo pagesat e çdo lloji e natyre të vlerësuara apo vjela mbi ose në lidhje me Operacionet Hidrokarbure në kuadrin e kësaj Marreveshje, përveç atyre të mbuluara nga Neni 9 i Marreveshjes.

10. Sigurimet dhe pretendimet

10.1 Primet e paguara për çdo detyrim publik, dëmtim prone dhe sigurime të tjera të bëra nga Kontraktori, së bashku me të gjitha shpenzimet e lindura dhe të paguara për zgjidhjen e të gjitha humbjeve, pretendimeve, dëmeve, gjykimeve dhe shpenzimeve të tjera, duke përfshirë shpenzimet për shërbimet ligjore, që nuk mbulohen nga kompania e sigurimit.

10.2 Të gjitha zgjidhjet që lindin nga pretendimet e Kontraktorit kundrejt siguruesve, për siguracionin e bërë në përfitim të Operacioneve Hidrokarbure te cilat mbulohen nga kompani shqiptare te sigurimit, do t'u kreditohen Kostove të Mbulueshme në muajin në të cilin janë marrë.

11. Administrata qendrore dhe lokale/zyrat në terren

11.1 Nderkohe qe Kontraktori kryen aktivitete sipas Marreveshjes, kostot e stafit dhe mbajtes se zyrave qendrore te Kontraktorit ne Republiken e Shqiperise, dhe/ose zyrave te tjera te ngritura ne Republiken e Shqiperise, do te ngarkohen ne Kostot Hidrokarbure.

11.2 Pagat dhe shpenzimet e drejtuesve dhe punonjësve të tjerë të Kontraktorit, të vendosur në Shqipëri, të cilët shërbejnë në Operacionet Hidrokarbure, koha e të cilëve nuk i ngarkohet direkt Operacioneve Hidrokarbure dhe kostoja e mirëmbajtjes dhe përdorimit të zyrave të Vleresimit dhe/ose Prodhimit dhe nën-zyrave të nevojshme (duke përfshirë objektet e strehimit për punonjësit, nëse kërkohet) të përdorura gjatë kryerjes së këtyre Operacioneve Hidrokarbure. Këto pagesa do të jenë proporcionale për gjitha zonat e Marreveshjes, nëse është e zbatueshme.

11.3 Kostot e transportit dhe akomodimit ne lidhje me mbledhjet e Komitetit Keshillimore, ne rast se do te kete te tilla, do te ngarkohen ne Kostot Hidrokarbure.

11.4 Kostoja e ngritjes, mirembajtjes dhe operimit te cdo zyre, nen-zyre, kampe, magazina, shtepi banimi dhe mjedise te tjera te tilla si mjedise shplodhese punonjesit. Nese keto mjedise do te sherbejne per me shume se nje zone Marreveshje atehere do te alokohen seciles mbi nje baze proporcionale.

12. Pagesat e trajtimit në magazinë

Në rast se për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure nevojiten objekte magazinimi, të gjitha kostot që nevojiten për të ngritur dhe mirëmbajtur magazinën dhe të gjitha kostot e kryera për trajtimin e materialeve në magazinë.

13. Shpenzime të tjera

Të gjitha shpenzimet e tjera që nuk mbulohen apo parashikohen në dispozitat e mësipërme, të cilat janë kryer nga Operatori për realizimin e Operacioneve Hidrokarbure në përputhje me Marreveshjen dhe Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë Hidrokarbure dhe të kryera nga Kontraktori sipas Programit të Punës dhe Buxhetit, të tilla si shpenzimet e braktisjes dhe shpenzimet për zgjidhjen e situatave emergjente.

14. Kreditimet

Te ardhurat neto te transaksioneve te meposhtme do te kreditohen ne llogarite sipas Marreveshjes:

14.1 Te ardhurat neto te ndonje sigurimi nese siguracioni eshte i rikuperueshem si kosto ose pretendim ne lidhje me operacionet hidrokarbure ose ndonje aset i ngarkuar ne llogari sipas Marreveshjes;

14.2 E ardhura e marre nga te trete per perdorim te pasurise ose aseteve te ngarkuara ne llogari sipas Marreveshjes, e cila eshte bere e tepert ne operacionet hidrokarbure dhe eshte dhene me qira ose shitur;

14.3 Cdo e ardhur e marre nga kontraktori nga furnizuesit/prodhuesit ose agjentet e tij ne lidhje me paisje ose materiale te difektuara, kostoja e te cileve eshte ngarkuar me pare nga kontraktori sipas Marreveshjes;

14.4 Rentat, financimet ose kreditime te tjera te marra nga kontraktori te cilat aplikohen ndaj cdo pagese e cila eshte bere ne llogari sipas Marreveshjes;

14.5 Te ardhurat nga te gjitha shitjet e materialeve te teperta ngarkuara ne llogari sipas Marreveshjes, ne llogarine neto aktuale te mbledhur;

15. Nuk duhet të ketë dublikim të detyrimeve dhe kreditimeve

Pavarësisht çdo dispozite që bien ndesh me këtë Procedurë Kontabël, synohet që të shmanget dublikimi i debitimeve apo kreditimeve në llogaritë sipas kësaj Marreveshje.

Neni III. Mbulimi i Kostove

1. Pasqyra e mbulimit të kostove

Kontraktori do t'i japë Albpetrolit, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por jo më vonë se dyzetë e pese (45) Ditë pas çdo Tremujori Kalendarik, një Pasqyrë të Mbulimit të Kostove për atë Tremujor. Për qëllimet e kësaj Procedure Kontabël dhe të Marreveshjes, Pasqyra e Mbulimit të Kostove nënkupton një dokument të dorëzuar Albpetrol-it nga Kontraktori, në të cilin përshkruhen zërat sipas kontabilitetit mbi bazë monetare, për çdo Tremujor Kalendarik dhe i cili përfshin totalin për të gjithë vitin dhe detyrimet e kreditimet kumulative që prej fillimit.

Në pritje të përfundimit të çdo auditimi dhe çdo zgjidhjeje apo vendimi gjykate në përputhje me Marreveshjen, Kontraktori do të përgatisë drejtpërdrejt per çdo Situacion te Veprimtarisë së Vleresimit dhe Veprimtarisë së Zhvillimit, për çdo Tremujor Kalendarik, Pasqyrën e Mbulimit të Kostove për atë Tremujor. Të gjitha rregullimet e nevojshme që rezultojnë pas përfundimit të auditimeve dhe zgjidhjeve (me çfarëdolloj mënyre) të kundërshtimeve në bazë të kontrollit/auditimit do të llogariten siç lindin dhe në përputhje me Marreveshjen, duke i përfshirë si debit apo kreditim (sipas rastit) në Pasqyrën e radhës të Mbulimit të Kostove që duhet të përgatitet; megjithatë, në këtë Pasqyrë nuk duhet të përfshihet asnjë Kosto e Refuzuar.

Në Pasqyrën e Mbulimit të Kostove do të paraqiten sa më poshtë:

1.1 Seksioni 1 - Kostot totale

1.1.1 Kostot totale të mbartura nga Tremujorët Kalendarikë të mëparshëm.

1.1.2 Rishikimet e reja (Kostot e Refuzuara dhe Kostot e Miratuara) të Situacioneve të mëparshme të Veprimtarisë së Zhvillimit dhe Prodhimit, që do aplikohen në këtë Situacion.

1.1.3 Kostot totale, duke përfshirë ato që i nënshtrohen auditimit.

1.2 Seksioni 2 - Vlera e Hidrokarbureve për Mbulimin e Kostos

(duke marrë në konsideratë çdo marrje të mëparshme të hidrokarbureve përkundrejt të drejtës).

1.2.1 Vlera e Gazit Natyror Bruto për Mbulim Kostoje e marrë në natyrë dhe e disponuar nga Kontraktori për Tremujorin Kalendarik, duke përfshirë totalin për vitin, si dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit.

1.2.2 Vlera e Gazit Natyror për Mbulim Kostoje e marrë në natyrë dhe e disponuar nga Kontraktori për Tremujorin Kalendarik, duke përfshirë totalin për vitin dhe detyrimet dhe kreditimet kumulative që prej fillimit.

1.2.3 Vlera totale e Hidrokarbureve për mbulimin e kostos (1.2.1 plus 1.2.2).

1.3 Seksioni 3 - Mbulimi i kostove

1.3.1 Kostot sipas seksionit 1 që mbulohen nga vlera e Hidrokarbureve për mbulimin e kostos.

1.3.2 Mbartja e Kostove të Pambuluara, nëse ka.

1.4 Seksioni 4 - Hidrokarbure Fitim

1.4.1 Vlera e Gazit Natyro Fitim, nëse ka.

1.5 Seksioni 5 - Llogaria e Kostove të Pezulluara

1.5.1 Totali i Kostove të Pezulluara, të mbartura nga Tremujorët e mëparshëm Kalendarikë.

1.5.2 Kostot të Pezulluara, të zgjidhura rishtazi ose të identifikuara rishtas nga auditimi, gjatë Tremujorit Kalendarik.

1.5.3 Totali i Kostove të Pezulluara, të mbartura në Tremujorin tjetër Kalendarik (1.5.1 plus 1.5.2).

1.6 Seksioni 6 -Kostot e Konstatuara/Përllogaritura

Një seksion që mbulon Situacionin e Kostove dhe të Ardhurave të Përllogaritura për Tremujorin Kalendarik përkatës dhe që duhet t'i mundësojë Albpetrol-it dhe AKBN-së një vështrim të përgjithshëm të kostove për të cilat Kontraktori është angazhuar, por të cilat nuk janë paguar ende ndaj furnitorëve përkatës. Për shmangien e çdo dyshimi, kostot e përfshira në Situacionin e Kostove dhe të Ardhurave të Përllogaritura mund të përfshihen në Situacionin e Mbulimit të Kostove për qëllime të mbulimit të këtyre kostove në çdo kohë përgjatë kohëzgjatjes së Marreveshjes, pavarësisht se kur angazhimet, blerja/prokurimi apo shërbimet që i atribuohen këtyre kostove janë ndërmarrë, pranuar apo kryer, për sa kohë zërat e prezantuara nga Kontraktori për mbulimin e kostove në Situacionin e Mbulimit të Kostove janë kryer dhe kanë ndodhur sipas termave dhe kushteve te kesaj Marreveshje."

2. Pagesat

Nëse një pasqyrë e mbulimit të Kostove paraqet një shumë që i duhet paguar AKBN-së, kjo shumë duhet të paguhet në dollarë brenda tridhjetë (30) Ditësh nga paraqitja e Pasqyrës në fjalë.

3. E drejta e auditimit

Në përputhje me paragrafin 3 të Nenit I të kësaj Procedure Kontabël, Albpetroli ka një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh dhe AKBN ka një periudhë prej tridhjetë e gjashtë (36) muajsh, sipas rastit, nga marrja e çdo Pasqyre të Mbulimit të Kostove që përmban kostot e Veprimtarive të Vleresimit, Zhvillimit dhe Prodhimit, për të audituar apo kundërshtuar këtë Pasqyrë. Albpetroli dhe Kontraktori bien dakord për çdo rregullim të duhur që rezulton nga auditimi në fjalë. Gjatë kësaj Periudhe, dokumentet mbështetëse dhe llogaritë do të vihen në dispozicion të Albpetrolit.

4. Llogaria e Kontrollit të Mbulimit të Kostove

Kontraktori do të mbajë një Llogari për Kontrollin e Mbulimit të Kostove dhe një kundër-llogari shlyerjeje për të kontrolluar shumën e kostove që mbeten për t'u mbuluar, nëse ka, shumën e kostove të mbuluara dhe vlerën e Hidrokarbureve Fitim, nëse ka. Këto llogari do të përgatiten mbi bazën e (dhe të jenë në konsistencë me) Situacioneve të Mbulimit të Kostove të Tremujorëve Kalendarikë.

ANEKSI D
INSTRUMENTI I TRANSFERIMIT

KY INSTRUMENT I TRANSFERIMIT eshte bere me date _____._____._____.

NDERMJET:

(1) ALBPETROL SH. A. ("Albpetrol"); nje Kompani Shteterore Shqiptare, zyrat qendrore te te ciles jane ne Patos, Shqiperi;

(2) EDG NATURAL GAS" SHPK ("EDG Natural Gas" nje person juridik shqiptar, me zyra ne Tirane, Shqiperi; dhe

(3) AGJENSIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE ("AKBN") nje entitet ligjor i autorizuar me Vendim No. 547, date 09 Gusht 2006 te Qeverise te Republikes se Shqiperise.

NDERSA:

Albpetroli eshte nje pale ne nje Liçense Marreveshje te bere me daten ____._____._____

Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise e perfaqesuar nga AKBN-ja dhe EDG Natural Gas deshiron te bashkohet me Albpetrolin ne kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure (siç percaktohet atje).

TANI KY INSTRUMENT DESHMON qe per shkak te dhe ne perputhje me hyrjen e EDG Natural Gas ne nje Marreveshje Hidrokarbure (siç percaktohet ne Liçense Marreveshje) me Albpetrolin:

(1) Per kete ketu, Albpetroli transferon gjithe te drejtat, privilegjet dhe detyrimet e tij sipas License Marreveshjes te permendur me siper EDG Natural Gas ne perputhje me Marreveshjen Hidrokarbure te lartpermendur.

(2) Albpetroli dhe EDG Natural Gas bien dakort qe ata do te jene pergjegjes ndaj Ministrise sipas Liçense Marreveshjes te lartpermendur per te gjitha detyrat dhe detyrimet e te Liçensuarit vetem siç percaktohet ne menyre specifike ne License Marreveshjen e lartpermendur.

(3) Me ekzekutimin e ketij Instrumenti Transferimi, AKBN-ja konfirmon se ajo ka dhene aprovimin paraprak me shkrim per kete transferim, qe EDG Natural Gas ka dorezuar ne AKBN deshmi te arsyeshme te kapacitetit te saj financiare dhe/ose teknike dhe qe AKBN-se i kerkohet qe te mos refuzoje miratimin e saj ne nje menyre te paarsyeshme dhe te pandershme dhe qe ata pranojne qe Albpetroli dhe EDG Natural Gas jane pale ne Liçense Marreveshjen e lartpermendur si te Liçensuar.

(4) Ky Instrument Transferimi kushtezohet me hyrjen e Albpetrolit dhe EDG Natural Gas ne Marreveshjen Hidrokarbure te lartpermendur dhe aprovimin prej Keshillit te Ministrave te kesaj Marreveshje Hidrokarbure.

(5) Ne vijim te nenshkrimit te ketij Instrumenti Transferimi, interesat e EDG Natural Gas dhe Albpetrolit do te jene siç percaktohen ne Marreveshjen Hidrokarbure ne fjale.

ME DESHMI PER SA ME SIPER, palet nenshkruajne kete Instrument Transferimi diten dhe vitin e shkruar ne faqen e pare.

FIRMOSUR nga
Me Autorizim te rregullt,
per dhe ne emer te
"Albpetrol" (KLEJDI CENMURATI)
30.05.2022

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISË
ALBPETROL Sh.a.
ADMINISTRATORI
PATOS

FIRMOSUR nga
Me Autorizim te rregullt,
per dhe ne emer te
"Kontraktorit" (ERALD BAKIU)

EDG NATURAL GAS
SH.P.K.
NIPT : M117070297
TIRANE - ALBANIA

FIRMOSUR nga
Me Autorizim te rregullt,
per dhe ne emer te
"AKBN" (Alion Byfyka)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
TIRANE

ANEKSI E
FORMA E GARANCISË BANKARE

GARANCIA BANKARE

Drejtuar

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE, TIRANË

Jemi informuar se [•] ("EDG Natural Gas" shpk ") është bërë titullari i vetëm i një Marreveshje Hidrokarbure per Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve ne Vendburimin e Gazit Natyror Povelç, Shqipëri me Albpetrol Sh.a., e cila ka hyrë në Fuqi më [•] (në vijim referuar si **MH**") dhe e kuptojmë se sipas dispozitave të MH-së kërkohet një garanci performance.

Jemi informuar gjithashtu se, sipas kushteve të MH, ["EDG Natural Gas" shpk•] ka marrë përsipër që gjatë Periudhës së Vleresimit [•] të zbatojë Programin e Punës në Zonën e Kontratës (të gjitha sipas përshkrimit në MH) dhe për këtë qëllim të shpenzojë shumën [•] dollarë amerikanë ([•] USD).

Me kërkesë të [•], ne [•], të përfaqësuar nga [•], me vendndodhje në [•], përmes kësaj garancie garantojmë dhe marrim përsipër t'ju paguajmë çdo shumë që nuk e kalon shumën [•] dollarë amerikanë ([•] USD), sipas rastit, pasi të kemi marrë kërkesën e parë të bërë nga ju në përputhje me procedurën për paraqiten e kërkesës që detajohet më poshtë ("**Garancia**").

Kërkesa duhet të bëhet në formë shkresore dhe duhet të shoqërohet nga:

- Deklarata ku të deklarohet se EDG Natural Gas shpk është në shkelje të detyrimeve të tij sipas Marreveshjes dhe në ç'drejtim EDG Natural Gas shpk është në shkelje:
- Kopjen e njoftimit drejtuar [•] (që daton të paktën (30) ditë përpara datës së kërkesës), ku të informohet [•] për shkeljen e detyrimeve që ka sipas Programit të Punës, për natyrën dhe masën e shkeljes, si dhe mbi qëllimin tuaj për të kërkuar pagesën sipas kësaj garancie, në rast se shkelja nuk korrigjohet brenda nëntëmbëdhjetë 90 ditëve nga data e njoftimit të bërë nga ana juaj; dhe
- Një deklaratë të nënshkruar, ku të deklarohet se [•] nuk e ka korrigjuar shkeljen e përcaktuar në njoftim brenda datës së specifikuar.

Çdo kërkesë sipas kësaj Marreveshje dhe dokumentet e specifikuara më lart duhet të na i dërgoni në adresën e lartpërmendur, në përputhje me procedurën e sipërpërmendur për bërjen e kërkesës deri në datën e përfundimit të kësaj garancie, siç përshkruhet më poshtë, datë pas së cilës kjo garanci nuk do të ketë më asnjë efekt.

Nuk do të pranohet kërkesa e dërguar me faks.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi jo më vonë se [•] dhe do të mbetet e vlefshme deri në (a) gjashtë (6) muaj pas përfundimit të Periudhës së Vleresimit [•] (b) datën në të cilën shuma totale e kësaj garancie të jetë tërhequr apo reduktuar siç përcaktohet në paragrafin vijues.

Shumës së kësaj garancie do t'i zbritet çdo muaj ose çdo tre muaj, siç mund të bihet dakord mes AKBN-së dhe EDG Natural Gas [●], gjatë Periudhës së [●] Vleresimit, një shumë e barabartë me shumën e shpenzuar nga EDG Natural Gas [●] në lidhje me detyrimet e tij sipas Programit të Punës gjatë muajit apo tremujorit në fjalë, dhe këto zbritje do të kryhen në përputhje me deklaratat mujore ose tremujore me shkrim të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore drejtuar [●], një kopje e të cilave na përcillet neve dhe ne i pranojmë si dëshmi përfundimtare për reduktimet e angazhimit tonë sipas kësaj garancie.

Kjo Garanci është personale dhe nuk mund t'i transferohet apo caktohet një personi tjetër.

Kjo garanci i nënshtrohet Rregullave te Bankes se Shqiperise.

ANEKSI F
PROCEDURA E MARRJES NE DOREZIM

A. Proçedurat e Pergjithshme te Marrjes ne Dorezim

Menjehere pas Dates Efektive, Albpetroli dhe Kontraktori do te kryejne nje transferim te pergjegjesive operacionale per Zonen e Projektit. Ky transferim perfshin, pa kufizim, transferimin dhe dorezimin te Kontraktori nga AKBN-ja, Albpetroli dhe çdo Filial i tyre te aseteve, te drejtave, dokumenteve dhe materialeve qe ndodhen ne Zonen e Kontrates ose ne zyrat e tyre respektive, dhe te perdorura ose te dobishme ne lidhje me aktivitetet ne Zonen e Projektit. Asetet, te drejtat, dokumentat dhe materialet do te jene ne menyre thelbesore te njejta si ato te pershkruara ne License Marreveshjen dhe kete Marreveshje dhe do te dokumentohet momenti i dorezimit te tyre.

B. Procedura e Marrjes ne Dorezim e Puseve

1. **Pergjegjesite e Kontraktorit**

a. Njoftim i Kontraktorit:

i. Kontraktori do t'i dorezojë Albpetrolit nje liste paraprake te puseve qe synohen te merren ne dorezim per çdo Tremujor Kalendarik, brenda tridhjete diteve nga fillimi i atij Tremujori Kalendarik. Kjo liste paraprake mund te rishikohet pas marrjes se informacionit te dosjeve te puseve dhe te jete verifikuar gjendja e kezingjeve.

ii. Do te jepet njoftim dy jave para dates se kerkuar per marrje ne dorezim.

iii. Nese Kontraktori zgjedh te kryeje pune verifikuese paraprake per kezingun duke perdorur sherbimet dhe autosonde te Albpetrolit, marrja ne dorezim nuk eshte zyrtare, derisa Kontraktori ka leshuar njoftim me shkrim qe i pranon kushtet e pusit. Per qellime te llogaritjes se Prodhimit te Gjykuar te nje pusi te vecante, data efektive e marrjes ne dorezim e pusit do te jete rotrespektivisht me daten ne te cilen filloi puna paraprake verifikuese e kezingut.

iv. Nese Kontraktori zgjedh te shtoje puse te tjere qe nuk jane ne listen paraprake per kete Tremujor Kalanderik, Albpetroli nuk do te kundershtoje ne menyre te paarsyeshme ose te vonoje kete aprovim.

b. Te Dhenat e Pusit dhe Sherbimet per Integritetin e Trungut te Pusit.

i. Kontraktori do te beje kerkese per informacionin qe kerkon ose me njoftim dorezuar dy jave para Tremujorit Kalendarik ose ne ndonje kohe tjeter.

ii. Kontraktori do t'i paraqese Albpetrolit programin e kerkesave per verifikim te kezingut te pusit dhe sherbimeve qe do ti kerkohen Albpetrolit per tu kryer. Eshte synim i Kontraktorit qe te marre ne dorezim vetem puse te cilet nuk shfaqin probleme te rendesishme intergriteti te trungut dhe pjeses fundore te kezingut. Nese nje pus gjendet se ka probleme te tilla, Kontraktori

do te ri-ule pajisjet si ne gjendjen para ketij sherbimi dhe me kosto te Kontraktorit, dhe

Kontraktori nuk do te kete detyrime te metejshme ne lidhje me nje pus te tille. Kontraktori merr persiper pergjegjesite per çdo pus, vetem me marrjen perfundimtare te pusit (me kusht qe sipas Marreveshjes Hidrokarbure, pergjegjesite per kushtet para marrjes ne dorezim mbeten te Albpetrolit).

iii Kontraktori mund ti kerkoje Albpetrolit te kryeje sherbime me autosonde per te verifikuar integritetin e kezingut dhe pune te tjera te pastrimit te trungut sipas programit te Kontraktorit. Kontraktori dhe Albpetroli do te bien dakort per nje Marreveshje Sherbimesh duke percaktuar kushtet dhe kostot per sherbimet e Albpetrolit me terma te njejta me ato qe ofrohen nga palet e treta arm's length. Nje Kerkese per Sherbime se bashku me programin do te paraqitet nga Kontraktori, nese ai do te kerkoje sherbime te Albpetrolit.

c. Ndertimi i Shesheve

i. Kontraktori do te heqe kullat dhe pajisjet ne vendin e percaktuar nga Albpetroli brenda Zones se Marreveshjes me kosto te Kontraktorit kur pusi merret ne dorezim per operacione prodhimi dhe jo per situaten kur ai eshte marre ne dorezim vetem per pezullim te operacioneve te Albpetrolit brenda siperfaqes se rezervuarit ose per qellime monitorimi.

ii. Kontraktori do te heqe ndotjen, tek vendi i percaktuar nga Albpetroli, per token e ndotur me kosto te Kontraktorit. Demtimet e Mjedisit per materialet e hequra i mbeten Albpetrolit si nje kondicion ekzistues.

iii. Kontraktori mund ti kerkoje Albpetrolit largimin e tokes se ndotur, heqjen e kulles dhe pajisjeve dhe ndoshta ndertimin e shesheve te reja te puseve. Kjo kerkese do te behet nepermjet nje Kerkese per Sherbime dhe te kryhet ne perputhje me nje Marreveshje Sherbimi.

iv. Kontraktori do te rindertoje sheshe sipas standarteve te veta dhe sipas rregullave dhe lejes se Mjedisit.

d. Marrja ne Dorezim e Puseve per Monitorim

i. Kontraktori mund te marre ne dorezim puse, por jo puse ne prodhim aktiv per arsye te monitorimit te kushteve te rezervuarit dhe per nxjerrje optimale nga rezervuari dhe parametrave te tij.

ii. Pergjegjesia per operacione te ardhshme ne keta puse do te jete e kufizuar ne trungun e pusit dhe ndonje fluid i çliruar nga keta. Kontraktorit nuk do ti kerkohet te heqe paisjet e Albpetrolit nga keto sheshe pusesh, ose te largoje ndonje ndotje. Nese paisjet do te kerkohen nga Albpetroli (me perjashtim te tubingut ne fundin e pusit i cili mund te kerkohet te mbetet ne trung), Albpetroli eshte i titulluar ti heqe me kosto te tij dhe kushtet konkrete te tij. Gryka e pusit do te mbetet e siguruar dhe e mbyllur me çeles, kurse energjia ne shesh e stakuar.

iii. I vetmi inventar i regjistruar per transferim do te lidhet me gryken e pusit dhe fundin e pusit.

iv. Kontraktori do te kete leje per te hyre ne kete shesh.

e. Inventari

i. Nje dite para marrjes ne dorezim zyrtarisht, perfaqesuesit e Kontraktorit dhe te Albpetrolit do te takohen ne sheshin e pusit per te kryer nje inventar te paisjeve qe do te merren ne dorezim nga Kontraktori.

ii. Inventari do te perfshihet ne formularin e marrjes ne dorezim qe do te firmoset si nga perfaqesuesit e Albpetrolit dhe te Kontraktorit. Kjo do te perfshije pergjegjesite paraekzistuese per Albpetrolin dhe marrjes se shesheve te puseve nga Kontraktori ne keto kushte.

iii. Duhet vene ne dukje qe inventari i marre ne dorezim mund te mos disponohet ne te ardhmen per shkak te konsumimit dhe shkaterrimit prej operacioneve, dhe Kontraktori nuk eshte pergjegjes ne ndonje menyre ta kthejne ne gjendjen e meparshme.

f. Para-ekzistues

i. Prodhimi para-ekzistues do te llogaritet mbi bazen e formules ne Marreveshjen Hidrokarbure dhe bazuar ne te dhenat e prodhimit te dhena nga Albpetroli. Kontraktori ka te drejten te shikoje ne detaje llogaritjet dhe metodat e tilla per llogaritjet e kaluara. Sapo te pranohet nga te dyja Palet, ky prodhim do te sherbeje si baze per llogaritje te prodhimit para-ekzistues ne te ardhmen.

2. Pergjegjesite e Albpetrolit

a. Dorezimi i sheshit dhe pusit

i. Albpetroli do te dorezoje tek Kontraktori brenda dy javesh pusin dhe sheshin nga kerkesa e Kontrakorit.

b. Te Dhenat e Pusit

i. Albpetroli do ti jape me daten 15 te çdo muaji pasardhes te dhenat e prodhimit (Hidrokarburet neto, ujin, dhe oret e prodhimit) per te gjithe puset brenda Zones se Kontrates qe jane Operuar nga Albpetroli.

ii. Albpetroli do te jape informacionet e dosjeve te puseve (ose kopje te orgjinalit) brenda nje jave prej kerkeses se Kontraktorit, si per nje pus qe merret ne dorezim ose per qellime te tjera.

c. Kushtet Para-ekzistuese

i. Kushtet Para-ekzistuese do te mbeten pergjegjesi e Albpetrolit. Materialet e ndotura te hequra nga sheshi para dates se marrjes ne dorezim do te shkojne ne sheshin e grumbullimit dhe trajtimit te percaktuar nga Albpetroli dhe mbeten detyrim i Albpetrolit.

ii. Sipas Marreveshjes Hidrokarbure, per secilin pus para marrjes ne dorezim, do te kryhet nje Studim Mjedisor te nivelit Baze per te identifikuar kushtet para ekzistuese. Albpetroli do te bashkepunoje me ndonje studim te tille. Nuk do te kryhen aktivitete te metejshme ne keto sheshe sapo te jete perfunduar kjo dhe Kontraktori ka marre ne dorezim pusin (pavaresisht per monitorim ose per prodhim).

iii. Nese cdo aktivitet nga Albpetroli ne sheshe te puseve te marre ne dorezim, do te çoje ne shkelje te menjehershme nga Albpetroli te detyrimeve te prodhimit para-ekzistues te meparshem dhe te ardhshem qe ka Kontraktori, atehere te gjitha detyrimet dhe shperblimet e demit jane ne ngarkim te Albpetrolit, me perjashtim kur Kontraktori pranon qe Albpetroli te nderprese keto aktivitete dhe te ri-pranohen pergjegjesite e marrjes ne dorezim.

d. Sherbimet ne Puse dhe Ndertimi i Shesheve te Puseve

i. Eshte e drejte e Kontraktorit qe te zgjedh te perdore mjete te Albpetrolit apo te Paleve te Treta, per kryerjen e sherbimeve te verifikimit te integritetit te kezingut te pusit para pranimit per ta marre disa sheshe pusesh. Albpetroli do te ofroje, nese do te jete i disponueshem dhe nese do kerkohet nga Kontraktori, nje traktor sonde per Kontraktorin brenda periudhes te njoftimit dhe sipas Marreveshjes se Sherbimit te rene dakort.

ii. Vetem per trungjet e puseve te cilet jane marre ne dorezim (jo sheshet e puseve) nga Kontraktori, Albpetroli do ti jape Kontraktorit leje te plote. Albpetroli do te siguroje qe energjia elektrike ne sheshet e puseve eshte shkeputur. Te gjitha paisjet siperfaqesore dhe kushtet e dhenies ne perdorim te tokes do te mbeten pergjegjesi e Albpetrolit. Cdo heqje e pajisjeve siperfaqesore do te jete me zgjedhje dhe kosto te Albpetrolit.

e. Inventari dhe Lirimi

i. Nje dite para dites se marrjes ne dorezim, perfaqesuesit e Kontraktorit dhe te Albpetrolit do te takohen ne vend per te bere nje inventar te paisjeve qe do te merren ne dorezim nga Kontraktori.

ii. Inventari do te perfshihet ne nje formular marrje ne dorezim qe do te leshohet dhe firmoset si nga perfaqesuesit e Albpetrolit dhe ata te Kontraktorit. Kjo do te perfshije pergjegjesite para-ekzistues (pervec pergjegjesive te mjedisit) per Albpetrolin dhe marrjes te sheshit te pusit nga Kontraktori ne ato kushte,

iii. Duhet vene ne dukje qe inventari i marre ne dorezim mund te mos jete i disponueshem ne te ardhmen, per shkak te prishjes dhe konsumimit normal dhe Kontraktori nuk eshte pergjegjes ne asnje menyre te ktheje inventarin ne kushtet ne te cilen u dorezuan tek Kontraktori.

ANEKSI G
PROGRAMI I VLERËSIMIT

Gjatë Programit të Vlerësimit do të realizohen nga EDG Natural Gas shpk, punimet e mëposhtme:

1. **Studim mjedisor i vendburimit**

EDG Natural Gas do te perpiloje nje Studim Mjedisor te Nivelit Baze per gjendjen aktuale te mjedisit ne Zonen e Kontrates, gjate fillimit te operacioneve hidrokarbure ne terren. Studimi do te mbuloje tere vendburimin ne teresi, si dhe puset qe do ti nenshtrohen punimeve te remontit ne vecanti.

2. **G&G dhe Mbledhja e të Dhënave të Puseve**

Të gjitha të dhënat e regjistruara në terren duhet të mblidhen dhe analizohen për të kuptuar më mirë rezervuarin dhe potencialin e mbetur të vendburimit. Të dhënat do të jenë si më poshtë:

- Të dhënat e puseve: përfundimi i pusit; matjet e presionit; të dhënat e prodhimit; kompletimi aktual; kampione shkëmbi apo shllame; prerje gjeologjike; të dhëna të shpejtësive, etj.
- Karrotazhet e pusit: karrotazhit; raportet e interpretimit;
- Të dhëna gjeologjike: raporte gjeologjike; përshkrimi i shllameve/prerjes gjeologjike.
- Profilet sizmike 2D: të dhëna sizmike në format dixhital dhe letër; stack dhe migrim.
- Lejet e ambjentit dhe planimetritë; Lejet dhe dokumenta kadastrale të Albpetrol për secilin pus në vendburim.

3. **Analizat e të Dhënave të Prodhimit dhe Rezervuarit**

Duhet të bëhet një analizë e kujdesshme për secilin rezervuar; të integrohen të gjitha të dhënat e prodhimit te gazit; parametrat e tyre; madhësia dhe shtrirja e shtresave gaz-mbajtëse; presioni fillestar dhe i mbetur, etj.

Qëllimi i kësaj analize është i dyfishtë: për të krijuar një model 3D të shpërndarjes së rezervuarit dhe përveç kësaj, për të ndihmuar në gjetjen e kandidatëve më të mirë që do të jenë objekt operacionesh në këtë fazë vlerësimi.

4. **Interpretimi Sizmik 2D dhe Vlerësimi i të Dhënave**

Të dhënat sizmike, së bashku me të dhënat e karotazheve të mbledhura, do të shndërrohen në një format dixhital dhe do të ngarkohen në ëëorkstation (SMT Software) dhe më pas do të shërbejnë për interpretimin e tyre. Rezultatet e interpretimit strukturor do të prodhojnë disa harta:

- Dyshemeja e Pliocenit: hartat e kohës / thellësisë.

- Tavani i Messinianit: harta e kohës dhe thellësisë.
- Tavani i Tortonianit: hartat e kohës / thellësisë.
- Hartat e trashësisë së Pliocenit dhe Miocenit të Sipërm.

Përveç interpretimit strukturor, integrimi i të dhënave sizmike do të përfshijë karrotazhit e puseve, duke u përpjekur qe të prodhojmë disa harta skematike të përhapjes se rezervuarit me rezolucion të ulët, për të kuptuar më mirë arkitekturën e rezervuarit, ku ndër këto mendohen të realizohen:

-harta faciale të rezervuarit;
-harta të ambjentit të depozitimit.

5. Punime Remonti

EDG Natural Gas shpk do të kryejë punime remonti sipas këtij programi paraprak:

Punime remonti: 2 puse

- Kontroll i integritetit të pusit.
- Nëse duhet, do regjistrohen karrotazhe të reja në pus (për çimentimin dhe ri-vlerësimin e rezervuarit).
- Nëse duhet, do të kryhen punime stimulimi dhe testimi të rezervuarit.

Duke realizuar operacionet e mësipërme të remontit, EDG Natural Gas shpk do të përfitoje të dhëna dhe eksperiencë për punimet e ardhshme të remontit, që do të bëhen në një shkallë më të gjerë, pasi të analizohen të dhënat e puseve në studim.

Paralel me punimet e remontit, EDG Natural Gas synon të studiojë dhe të përgatis për shpim një pus të devijuar (sidetrack well), duke shfrytëzuar trungjet e puseve ekzistues, nëse të dhënat e kompleksit gjeologo-gjeofizik e mbështesin një gjë të tillë.

6. Punime te Infrastruktures

Punimet e remontit ne vendburimin e Povelces do te krijojne mbeshtetje me punime te infrastruktures, pa u kufizuar ne: riparimin e rrugeve hyrese, shesheve te puseve apo infrastrukturen qe lidhet me ruajtjen dhe mbrojtjen e puseve, etj.

Ne keto punime do te perfshihen dhe riparimi apo zevendesimi i paisjeve siperfaqesore qe do te bejne te mundur testimin, perpunimin dhe shfrytezimin e gazit natyror ne kete faze vleresimi.

7. Punime te tjera

-Punime te tjera te se njejtes natyre qe lidhen me Periudhen e Vleresimit.

-Ne qofte se EDG Natural Gas shpk gjate Fazes se Vleresimit, do te arrije te prodhoje gaz natyror nga punimet e remontit apo te shpimit te puseve te rinj, atehere EDG Natural Gas do te kete te drejten ta prodhoje dhe ta shes produktin e saj ne treg.